



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 1

Tiranë – E mërkurë, 4 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 27.12.2022	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023..... 3
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 877, datë 27.12.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 61
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 240, datë 16.12.2022	Për përcaktimin e vlerës së investimit për pajisjen me leje unike për investitor..... 97
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm, i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe i Shërbimit Informativ të Shtetit nr. 242, datë 20.12.2022	Mbi bashkëpunimin e strukturave të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt 97
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022	Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore 110
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 558, datë 29.12.2022	Mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”..... 114
Udhëzim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 559, datë 29.12.2022	Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë..... 124
Urdhër i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 336, datë 22.12.2022	Për delegim kompetencash 127

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 313, datë 6.12.2022	Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.	127
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 314, datë 6.12.2022	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 395, seria F18 të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	129
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 724/7, datë 29.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës së mbrojtur nga lumi Osum dhe rijetëzimi i fasadave të qendrës së qytetit Ura Vajgurore”.....	130
	Kërkesë për deklarimin e vdekjes së shtetasit Kaso Karafili.....	133



VENDIM
Nr. 862, datë 27.12.2022

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
PËRGJITHSHËM ANALITIK
TË PROJEKTAKTEVE QË DO TË
PARAQITEN PËR SHQYRTIM
NË KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË
VITIT 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të

Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
KRYEMINISTRI / ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	“Për rregullat e hollësishtme për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, pagesën, çmimin favorizues, kategoritë e subjekteve që përfitojnë falje, si dhe përqindjet për zbritjet dhe përdorimit të bonove të privatizimit”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori i parë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 20/2020	Përcaktimi i rregullave, pagesës, çmimit favorizues, kategorisë së subjekteve që përfitojnë falje në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë nëpërmjet legalizimit	Jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun “Siguria e pronës” (faqe 47-48)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Po ndikim financiar dhe social
2	“Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Infrastruktura për monitorimin e mjedisit” ^{nc}	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujori i parë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/o, të ligjit 72/2012 “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shoqëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM nr. 402, datë 20.5.2020.	Jo
3	Projektvendim, “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Infrastruktura industriale” ^{nc}	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujori i parë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/p, të ligjit 72/2012 “Infrastruktura industriale”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shoqëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM Nr. 402, datë 20.05.2020.	Jo
4	Projektvendim, “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Habitatet” ^{nc}	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujori i parë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/x, të ligjit 72/2012 “Habitatet”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shoqëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM nr. 402, datë 20.05.2020.	Jo
5	“Për miratimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i parë	Rritja dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në fushat prioritare	Përcaktimi i prioritetve dhe operacionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë me Francën, sektorët e bashkëpunimit,	Jo	Kapitulli për Integrimin Evropian, Mirëqenie për të gjithë, Modernizimi dhe Zhvillimi,	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030, Dokumenti i Politikave Strategjike	Po



	SASPAC dhe Agjencisë Franceze të Zhvillimit”.					ndarja/shkëmbimi i informacionit, modalitetet e implementimit, periudha e zbatimit		Energjia, Turizmi dhe Mjedis, Shoqëria digitale	dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035, Strategjia Ndërsëktoriale “Agjenda Digitale e Shqipërisë” dhe Planit i Veprimit 2022–2026	
6	“Për Miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, për mbështetjen buxhetore në përballimin e krizës energjetike për vitin 2023”.	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i parë	Detyrimet e parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Pas miratimit, Marrëveshja do të nënshkruhet nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s, dhe vetëm pas këtij nënshkrimi, fondet për mbështetjen buxhetore në sektorin e energjisë do të behën të aksesueshme.	Projekt akti rregullon prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes.	Jo	Shtylla 5 e programit të qeverisë “Shqipëri e fortë, me shtet të fortë, vëmendje për çdo Shqiptar dhe me dinjtet në botë”, Integrimi Evropian.	Strategjia kombëtare e energjisë 2018–2030;	Po
7	“Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 6.3.2019, “Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët,”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori i dytë	Projektvendimi synon ndryshimin e disa prej anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez, duke qenë se një disa prej tyre nuk janë më pjesë e institucioneve përkatëse.	Projektvendimi synon ndryshimin e disa prej anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez, me qëllim funksionimin e Komisionit Shqiptaro-Malazez, në zbatim të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.	Jo	Integrimi Evropian, Mjedis	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2030	Jo
8	“Për modelin dhe rregullat e mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori i dytë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji” Për Kadastrën”	Përcakton rregullat që do të ndjek ASHK në rastet e regjistrimit të lejeve të ndërtimit në regjistrat kadastral, dhe miraton modelin e këtij regjistri, në zbatim të pikës 3 të nenit 48 të ligjit nr. 111/2018” Për Kadastrën”	Jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun “Siguria e pronës” d (faqe 47–48)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020 (kapitulli II)	Jo, ka karakter teknik
9	“Përcaktimi i rregullave të detajuara mbi zbatimin e procedurës së regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes/porosisë apo	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori i dytë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji” Për Kadastrën”	Përcakton rregullat me të detajuara që do të ndjek ASHK në rastin e paraqitjes për regjistrim në regjistrat kadastral të kontratave të	Jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun “Siguria e	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale	Jo, ka karakter teknik



	premtim shitje”					sipërmarjes/porosisë apo premtim shitje, në zbatim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr.111/2018, “Për Kadastrën”.		pronës” (faqe 47-48)	“Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	
10	, “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Zonat me përdorim të kufizuar”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujor i dytë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/rr, të ligjit 72/2012 “Zonat me përdorim të kufizuar”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shqipëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM nr. 402, datë 20.5.2020.	Jo
11	“Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujor i dytë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/n, të ligjit 72/2012 “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shqipëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM Nr. 402, datë 20.05.2020.	Jo
12	“Për miratimin e Strategjisë Ndërkombëtare të Ekonomisë Blu 2023 - 2030”.	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujor i dytë	Arsyeja kryesore është rregullimi ligjor i sektorit të marinave dhe potenciali i identifikuar për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar që kanë sektorin i detarisë, turizmit blu, peshkimit, ushqimeve të detit etj.	Rregullon Zhvillimin dhe transformimin e ekonomisë detare të Shqipërisë në një kontribues kryesor të rritjes së qëndrueshme duke ngritur traditën e lundrimit dhe mbështetur zhvillimin e turizmit detar, peshkimit, atë sportive dhe argëtuese me mekanizma dhe mjete të pajtueshme me mjedisin në të gjithë bregdetin.	Jo specifikisht por lidhet ngushtësisht me kapitujt 13: Peshkimi, 14: Politikat e Transportit, 19: Politika sociale dhe Punësimi, 22: Politikat e zhvillimit Rajonal, 27: Mjedis, 20: Politikat Industriale, 8: Politika e Konkurrencës etj.	Faqe 23 e Programit.. “Objektiv Strategjik I Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e transportit detar. Komplementimit me zona të zhvillimit ekonomik.. Akomodimin dhe shërbimet për mjetet lundruese turistike...	SKZHIE 2021-2030 : Agjenda e Konektivitetit (Shtylla nr. 3): Ekonomia Blu, Str për Zhv. e Turizmit 2019-2023 obj. 2.3, 3.1, Str. Sektoriale e Transportit 2021 (1.1 Sisteme eficiente portuale dhe të marinave), SDG 8, SDG 14: Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve të marinave)	Pozitive (impakte të përgjithshme) 1. Rritja e ndërkonektivitetit (ndërlidhjeve) 2. Rritja ekonomike (dhe e punësimit), 3. Rritje e Energjisë së Rinovueshme, 4. Zhvillim i peshkimit (eksporteve nga 130 mln USD (2021 në 200 mln USD në 2030, KPI SKZHIE III), sigurisë ushqimore dhe akuakulturës, Negative (impakte të përgjithshme) 1. Mbipeshkimi, 2. Degradimi i Habitatit, 3. Disbalanca në tregti (pjesa detare me pjesën tokësore të një vendi) 4. Zhvillimi <i>ad hoc</i> i paplanifikuar mbrapa midis bregdetit dhe tokës, 5. Rritja e kostove të jetesës për komunitetin që nuk përfshihet ose për peshkatarët e vegjël artizanë etj.
13	“Për miratimin e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare”.	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujor i dytë	Parashikuar në Draft VKM, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” e cila është në fazë bashkërendimi dhe	Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike që kanë rëndësi strategjike për sa	Jo	Jo	Jo	Jo



					pritet të miratohet brenda muajit dhjetor	i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Kjo listë shërben si instrument për mbështetjen e politikave dhe prioritetëve të Qeverisë Shqiptare, në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), si edhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare shërben si referencë për ministrinë përgjegjëse për financat dhe njësitë e qeverisjes qendrore, në kuadër të përfshirjes së projekteve të investimeve publike në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo Buxhetin Vjetor.				
14	“Për miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, për Programin e Veprimit IPA për vitin 2022 për Shqipërinë”.	Projektvendum	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i dytë	Detyrimet e parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Pas miratimit, Marrëveshja do të nënshkruhet nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s, dhe vetëm pas kësaj nënshkrimi, fondet behën të aksesueshme dhe mund të përdoren për zbatimin e projekteve konkrete.	Projektakti rregullon prioritetet tematike të programit, strukturat, autoritetet, palët, mënyrat e financimit të projekteve, alokimet dhe kushtet financiare të marrëveshjes.	Jo	Shtylla 5 e programit të qeverisë 'Shqipëri e fortë, me shtet të fortë, vëmendje për çdo Shqiptar dhe me dinjitet në botë', Integrimi Evropian.	Plani strategjik për Parlamentin 2020-2025”; Strategjia në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025; Strategjia Kombëtare për sigurinë kibernetike 2020-2025; Strategjia Kombëtare për punësimin dhe aftësitë 2019-2022; Strategjia Kombëtare e Rinisë; Strategjia Kombëtare për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve;	Po
15	“Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Rajoni i Pulias dhe Komisionit Evropian Për Programin Interreg IPA III BNK Adriatiku Jugor 2021-2027”.	Projektligj	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i dytë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Me miratimin e kësaj projektakti, Shqipëria bëhet përfituese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe penudhën kohore, et.	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura Shoqëria digjitale Integrimi Evropian	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Po
16	“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së	Projektligj	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i dytë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe	Po



	Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës, përfaqësuar nga Rajoni "Provence-Alpes-Côte d'Azur" dhe Komisionit Evropian Për Programin Interreg Euro MED 2021-2027".				ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, et.		dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura Shoqëria digjitale Integrimi Evropian	Integrim	
17	"Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Evropian Për Programin Interreg IPA III BNK Greqi-Shqipëri 2021-2027".	Projektligji	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujoni i dytë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, et.	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura Shoqëria digjitale Integrimi Evropian	Strategia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Po
18	"Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Rajoni i Emilia Romanjes dhe Komisionit Evropian Për Programin Interreg Adriatic-Ionian 2021-2027".	Projektligji	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujoni i dytë	Detyrimet e parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, et.	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura Shoqëria digjitale Integrimi Evropian	Strategia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Po
19	"Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian Për Programin IPA BNK Shqipëri-Kosovë 2021-2027".	Projektligji	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujoni i dytë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, et.	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura Shoqëria digjitale Integrimi Evropian	Strategia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Po
20	"Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian	Projektligji	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujoni i dytë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfutuese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura	Strategia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Po



	Për Programin IPA BNK Mal i Zi-Shqipëri 2021-2027”.				përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, et.		Shoqëria digjitale Integrimi Evropian		
21	“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Evropian Për Programin IPA BNK Maqedoni e Veriut-Shqipëri 2021-2027”.	Projektligj	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (SASPAC)	Katërmujori i dytë	Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfituese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program.	Projektakti parashikon prioritetet dhe për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, et.	Jo	Modernizim për zhvillim Zhvillimi I bujqësisë dhe fshatit Infrastruktura Energjia Turizmi dhe mjedisi Kultura Shoqëria digjitale Integrimi Evropian	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Po
22	“Për miratimin e Planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasë të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (Territori i Njësisë Administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të Bashkisë Shkodër dhe Njësinë Administrative Bushat të Bashkisë Vau i Dejës)”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori i tretë	Projektvendimi ka si qëllim miratimin e një Planit të Menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për disa zona, i cili i shërben institucioneve shtetërore, enteve publike e private për të menaxhuar në mënyrë të harmonizuar rrezikun nga përmbytjet dhe marrjen e masave efektive, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në zonat respektive.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. Zbatimi i planit të masave dhe rekomandimeve të Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet do të ndikojnë në uljen e rrezikut dhe risqeve që vijnë nga përmbytjet në territorin e njësisë administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës si dhe do të arrijnë objektivat me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.	Jo	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2015-2020, si dhe Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027	Po
23	“Për miratimin e Planit të Menaxhimit të basenit ujor të lumit Erzen”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori i tretë	Projektvendimi ka si qëllim miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor për lumin Erzen. Qëllimi i hartimit të Planit është përcaktimi i statusin aktual të trupave ujorë brenda një rajoni baseni dhe të përcaktojë se çfarë masash janë planifikuar për të përbushur objektivat mjedisore. Ky plan do të shërbejë	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe	Jo	Integrimi Evropian, Mjedisi	SKZHI 2015-2020, si dhe Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2028	Po



					si një mekanizëm themelor i inventarit dhe arkivimit për informacionin e mbledhur, mbi cilësinë dhe sasinë e ujit dhe mbi ndikimin kryesor të veprimtarisë njerëzore (presionet) në statusin e trupave ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujqore koordinojë bashkëpunimin ndërinstitucionale nëpërmjet zbatimit të programit e masave në lidhje me fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujqore dhe shërbejnë si mekanizmi kryesor raportues i autoriteteve të baseneve ujqore në BE.	periudhë të përcaktuara. Përbajnë një përshkrim të detajuar të karakteristikave të çdo trupi ujqor brenda rajonit të basenit ujqor, të ndikimeve dhe aktiviteteve të mundshme si në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujqor për lumin Erzen do të shërbejë si një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për menaxhimin e mjedisit ujqor ku përfshihen objektivat dhe masat e nevojshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujqor. Gjithashtu përcakton objektivat, standardet dhe masat ligjrisht të detyrueshme për të pëmbushur objektivat e ujit për të gjithë sektorët e ekonomisë.				
24	“Për miratimin e Planit të Menaxhimit të basenit ujqor të lumit Ishëm”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori i tretë	Projektvendimi ka si qëllim miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujqor për lumin Ishëm. Qëllimi i hartimit të Planit është përcaktimi i statusin aktual të trupave ujqorë brenda një rajoni baseni dhe të përcaktojë se çfarë masash janë planifikuar për të pëmbushur objektivat mjedisore. Ky plan do të shërbejë si një mekanizëm themelor i inventarit dhe arkivimit për informacionin e mbledhur, mbi cilësinë dhe sasinë e ujit dhe mbi ndikimin kryesor të veprimtarisë njerëzore (presionet) në statusin e trupave ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujqore koordinojë bashkëpunimin ndërinstitucionale nëpërmjet zbatimit të programit e masave në lidhje me fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujqore dhe shërbejnë si mekanizmi kryesor raportues i autoriteteve të baseneve ujqore në BE.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore. Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujqore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujqore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar. Përbajnë një përshkrim të detajuar të karakteristikave të çdo trupi ujqor brenda rajonit të basenit ujqor, të ndikimeve dhe aktiviteteve të mundshme mbi trupat ujqor si në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujqor për lumin Ishëm do të shërbejë si një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për menaxhimin e mjedisit ujqor ku përfshihen objektivat dhe masat e nevojshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujqor. Gjithashtu përcakton objektivat, standardet dhe masat ligjrisht të detyrueshme për të pëmbushur objektivat e ujit për të gjithë sektorët e ekonomisë.	Jo	Integrimi Evropian, Mjedi	SKZHI 2015-2020, si dhe Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujqore 2018-2029	Po
25	“Për miratimin e Planit të Menaxhimit të basenit ujqor të lumit Mat”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori i tretë	Projektvendimi ka si qëllim miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujqor për lumin Mat.	Projektvendimi është në vijim të akteve nënligjore që synojnë të plotësojnë dhe përmirësojnë	Jo	Integrimi Evropian, Mjedi	SKZHI 2015-2020, si dhe Strategjia Kombëtare e	Po



					Qëllimi i hartimit të Planit është përcaktimi i statusin aktual të trupave ujqorë brenda një rajoni baseni dhe të përcaktojë se çfarë masash janë planifikuar për të përbushur objektivat mjedisore. Ky plan do të shërbejë si një mekanizëm themelor i inventarit dhe arkivimit për informacionin e mbledhur, mbi cilësinë dhe sasinë e ujit dhe mbi ndikimin kryesor të veprimtarisë njerëzore (presionet) në statusin e trupave ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujqore koordinojë bashkëpunimin ndërinstytucionale nëpërmjet zbatimit të programit e masave në lidhje me fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujqore dhe shërbejnë si mekanizmi kryesor raportues i autoriteteve të baseneve ujqore në BE.	kuadrin ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujqore. Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujqore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujqore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar. Përbajnë një përshkrim të detajuar të karakteristikave të çdo trupi ujqor brenda rajonit të basenit ujqor, të ndikimeve dhe aktiviteteve të mundshme mbi trupat ujqor si në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësor. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujqor për lumin Mat do të shërbejë si një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për menaxhimin e mjedisit ujqor ku përfshihen objektivat dhe masat e nevojshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujqor. Gjithashtu përcakton objektivat, standardet dhe masat ligjorë të detyrueshme për të përbushur objektivat e ujit për të gjithë sektorët e ekonomisë.			Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujqore 2018-2030	
26	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”	Projektligj	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (APP)	Katërmujori i tretë	Përafrimi i mëtejshëm i ligjit me Direktivat 24/2014 dhe 25/2014 - Adresimi i problematikave të hasura nga zbatimi i ligjit prej muajit mars 2021 në praktike nga autoritetet kontraktore/operatoret ekonomike, si dhe organet e ndryshme audituese	Përafrimi i mëtejshëm me Direktivat, duke parashikuar konceptin e veprimtarive ndihmëse dhe ofruesit të shërbimit të prokurimit; saktësim të kompetencave të APP në drejtim të monitorimit të zbatimit të kontratës; konsiderimin e autoriteteve kontraktore sipas numrit të punonjësve, saktësim të terminologjisë së përdorur në disa dispozita ligjore etj.	Po, Kapitulli 5 “Prokurimi Publik”	Jo	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik miratuar me VKM 850/2020	Po
27	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (APP)	Katërmujori i tretë	Ndryshimi i VKM 285/2021, vjen si rezultat i ndryshimeve që mund të pësojë ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, por edhe si rezultat i adresimit të problematikave të hasura në praktikë nga autoritetet kontraktore dhe jo vetëm.	Rishikimi i kufijve monetare, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me Direktivat e BE. Zhvillimi dhe zgjerimi në VKM i konceptit të veprimtarive ndihmëse, Saktësimi i momentit të dorëzimit të kthimit të mostrave në procesin e prokurimit etj.	Po, Kapitulli 5 “Prokurimi Publik”	Jo	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik miratuar me VKM 850/2021	Jo
28	“Për miratimin e metodologjisë për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori i tretë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji” Për Kadastrën”	Përcakton metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme(tokës) në RSH, në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr. 111/2018 “ Për Kadastrën”	Jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun “Siguria e	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale	Po, ndikim ekonomik dhe social



								pronës” (faqe 47 – 48)	“Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	
29	“Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori i tretë	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji” Për Kadastrën”	Përcaktojë hartën e vlerës së tokës në RSH (pasurive të paluajtshme truall, tokë bujqësore, pyll, livadh, kullore), në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”	Jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun “Siguria e pronës” (faqe 47-48)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Po ndikim financiar dhe social
30	“Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Zonat ekologjike”	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujori i tretë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/v, të ligjit 72/2012 “Zonat ekologjike”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shoqëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM nr. 402, datë 20.5.2020.	Jo
31	, “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Shpërndarja e specieve”“	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujori i tretë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/xh, të ligjit 72/2012 “Shpërndarja e specieve”.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shoqëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM nr. 402, datë 20.5.2020.	Jo
32	, “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore të GIS-it Kombëtar”“	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Katërmujori i tretë	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e GIS-it Kombëtar sipas përcaktimeve në nenet 16 dhe 17 të ligjit nr. 72/2012.	Jo	Angazhimi nr. 77, Shoqëria digjitale, “Përmirësim dhe modernizim i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët”.	Dokumenti I politikave, “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM nr. 402, datë 20.5.2020.	Jo



PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	„Për miratimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin”	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i parë	Hartimi dhe miratimi i strategjisë ka si qëllim përcaktimin e politikave për zhvillimin e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorëve socialë, ekonomikë dhe kulturorë të vendit.	Nëpërmjet miratimit të kësaj strategjie synohet të përcaktohen politikat, vizioni, qëllimi dhe objektivat strategjike të zhvillimit të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si 3 prioritetet të rëndësishme kombëtare për zhvillimin e ekonomisë.	Po - Kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”	Nuk përputhet	Jo	Po ka efekte financiare, ekonomike, sociale dhe mjedisore.
2	“Për disa ndryshime në vendimin nr. 486, datë 17.6.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i parë	Hartimi, bashkërendimi dhe miratimi i ndryshimeve të akteve nënligjore për tekstet shkollore, për të mundësuar pajisjen e nxënësve të klasave nga I-III me tekste shkollore të reja falas, në përputhje me programin e ri qeverisës.	Hartimi, bashkërendimi dhe miratimi i ndryshimeve të akteve nënligjore për tekstet shkollore, për të mundësuar pajisjen e nxënësve të klasave nga I-III me tekste shkollore të reja falas, në përputhje me programin e ri qeverisës.	Jo	Po. Fusha e arsimit, angazhimi “Tekstet shkollore falas për të gjithë nxënësit e arsimit bazë”.	Po, lidhet me SKA 2021-2026. Produkti A.4.1 “Pajisja e shkollave me mjete mësimore për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe lënia në përdorim falas 2 vite e teksteve shkollore.”	Po ka efekte financiare, ekonomike dhe sociale. Jo nuk ka efekte mjedisore
3	“Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë, jashtë vendbanimit”.	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i parë	Hartimi i këtij projektvendimi ka si qëllim përcaktimin e kushteve për përballimin nga fondet publike të transportit të punonjësve arsimorë dhe të nxënësve etj.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet të përcaktohen kushtet optimale për të garantuar kryerjen e shërbimit të transportimit të punonjësve arsimorë, nxënësve etj.	Jo	Po. Fusha e arsimit	Po lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 (SKA 2021-2026).	Po ka efekte financiare dhe ekonomike. Ka efekte sociale dhe mjedisore.
4	“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Komizën Shqiptare të Kualifikimeve”, i ndryshuar”	Projektligj	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Nëpërmjet ndryshimit të këtij ligji synohet të rregullohen çështje që lidhen me njohjen e kualifikimeve.	Projektligji ka si qëllim të rregullojë çështje që lidhen me zbatueshmërinë e marrëveshjeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera për njohjen e kualifikimeve.	Po- Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”	Po. Fusha e arsimit. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë	Jo	Jo nuk ka efekte financiare dhe mjedisore. Po ka efekte sociale.
5	“Për disa ndryshime në vendimin nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë”	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Hartimi i këtij projektvendimi ka si qëllim të rregullojë ndarjen e grantit për kërkimin shkencor në IAL.	Nëpërmjet ndryshimit të këtij vendimi synohet të përmirësohet metodologjia e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të IAL-ve, si dhe përcaktimin e pikëzimit të treguesve që përbëjnë kriteret e metodologjisë së vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-	Jo	Po. Investimet për kërkimin shkencor dhe sigurimi i integritetit akademik dhe shkencor të IAL-ve	Po lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 (SKA 2021-2026). Objektivi specifik C.2: Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.	Mund të ketë efekte financiare. Nuk ka efekte dhe mjedisore.



						shkencore.				
6	“Për disa ndryshime në vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Rekomandim i Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Vendimi Nr. 135, datë 22.07.2021)	Parashikimi i lehtësimeve financiare për të ndjekur studimet në ciklin e dytë, të kategorive të caktuara të studentëve Përfshirja e studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në IAL-të jopublike si pjesë e politikave që MAS kërkon të zhvillojë në fushën e arsimit të lartë, me qëllim për të siguruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës	Jo	Po. Fusha e arsimit	Po, lidhet me SKA 2021-2026. Objektivi specifik C.5 të Objektivi specifik C.5: “Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare”; Produkti C.5.1 “Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët”; Masa C.5.1.1 “Dhënia e bursave për studentët ekselentë dhe studentët në nevojë”.	Po ka efekte financiare, ekonomike dhe sociale. Jo nuk ka efekte mjedisore
7	Për një ndryshim në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Hartimi i këtij projektvendimi është një detyrim ligjor i përcaktuar në pikën 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet ndryshimi i notës mesatare, për përfitim të uljes së tarifës së studimit për programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë.	Jo	Nuk përputhet	Po lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 (SKA 2021-2026). Fusha “Gjësia në arsimin e lartë”.	Jo nuk ka efekte financiare, ekonomike, mjedisore. Po ka efekte sociale.
8	“Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar,	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Hartimi i këtij projektvendimi është një detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.	Hartimi i këtij projektvendimi ka ardhur si nevojë e përmirësimit të vazhdueshëm të arrijve akademike të studentëve dhe përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë. Arsimi i Lartë duhet t’u përgjigjet nevojave të tregut të punës, drejtimeve të zhvillimit të vendit si dhe vendosjes në qendër të veprimtarisë së IAL-ve të cilësisë, mundësive të barabarta, meritës dhe aksesit për të gjithë.	Jo	Nuk përputhet	Po lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 (SKA 2021-2026). Fusha “Gjësia në arsimin e lartë”.	Jo nuk ka efekte financiare, ekonomike, mjedisore. Po ka efekte sociale.
9	, “Për miratimin e programit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Zgjerimi i bashkëpunimit me Bullgarinë në arsim, shkencë dhe kulturë, rritja e shkëmbimeve universitare dhe bursave, nxitja e projekteve të përbashkëta në	Zgjerimi i bashkëpunimit me Republikën e Bullgarisë në arsim, shkencë dhe kulturë, rritja e shkëmbimeve universitare dhe bursave,	Jo	Po. Fusha e arsimit	Jo	Po ka efekte ekonomike, financiare dhe sociale. Jo nuk ka efekte mjedisore



	bashkëpunim në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës”				kërkimin shkencor etj. Ky projektakt bazohet në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.	nxitja e projekteve të përbashkëta në kërkimin shkencor etj.				
10	Për disa ndryshime në vendimin nr. 662, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”.	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i dytë	Hartimi i këtij projektvendimi është një detyrim ligjor i përcaktuar në pikën 1 të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet përshtatja e vendimit në fuqi me ndryshimet e legjislacionit, në mënyrë që të përmirësohen kriteret dhe procedurat e hapjes dhe mbylljes së institucioneve arsimore parauniversitare publike.	Jo	Nuk përputhet	Po lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 (SKA 2021-2026).	Jo nuk ka efekte financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale.
11	“Për shkencën në Republikën e Shqipërisë”	Projektligji	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Nëpërmjet hartimit të këtij projektligji synohet rregullimi i sistemit të kërkimit shkencor dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme ose plotësuese të kërkimit në Republikën e Shqipërisë.	Projektligji ka për qëllim të përcaktojë parimet bazë të shkencës dhe kërkimit shkencor, strukturën institucionale e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe ndarja në profile të tyre.	Po - Kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”	Nuk përputhet	Jo	Po ka efekte financiare, ekonomike, sociale dhe mjedisore.
12	“Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS IV)”.	Projektligji	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Ratifikimi I marrëveshjes është një detyrim ligjor I përcaktuar në nenit 17 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.	Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet të nxitet programi i shkëmbimit të studentëve, personelit akademik, kërkuesve shkencor duke garantuar bursa për të promovuar lëvizjen dhe bashkëpunimin ndërmjet universiteteve në Evropën Qendrore.	Jo	Po. Fusha e arsimit	Jo	Po ka efekte financiare, ekonomike dhe sociale. Jo nuk ka efekte mjedisore
13	“Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore”.	Projektligji	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Hartimi i këtij projektligji është realizimi i interesit publik për ofrimin e shërbimeve arsimore cilësore.	Nëpërmjet hartimit të këtij projektligji synohet realizimi i interesit publik për ofrimin e shërbimeve arsimore cilësore dhe me standarde si edhe sigurimin e një procesi vlerësimi dhe monitorimi të testeve, vlerësimeve dhe provimeve në sistemin arsimor, i cili të jetë eficient, i pavarur dhe transparent, në përputhje me politikat shtetërore arsimore dhe standardet ndërkombëtare në arsim.	Jo	Nuk përputhet	Jo	Po
14	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar”	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Hartimi i këtij projektvendimi është një detyrim ligjor i përcaktuar në pikën 1 dhe 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.	Nëpërmjet këtij vendimi synohet të përcaktohen elementet e programeve të formimit të vazhduar në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore, të ofruara nga IAL-të.	Po- Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”	Po. Fusha e arsimit	Po lidhet me SKA 2021-2026. Objektivi specifik C.1: Rritja e cilësisë. Objektivi specifik C.3: Ndërlidhja me tregun e punës.	Jo nuk ka efekte financiare, mjedisore dhe sociale



15	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar”.	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Hartimi i këtij projektvendimi është një detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet ndryshimi i notës mesatare vjetore të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.	Jo	Nuk përputhet	Po lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 (SKA 2021-2026). Fusha “Gjësia në arsimin e lartë”.	Jo nuk ka efekte financiare, ekonomike, mjedisore. Po ka efekte sociale.
16	“Për hapjen, mbylljen, ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë” (rast pas rasti, sipas kërkesave të IAL-ve)	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Nëpërmjet aktit synohet hapja/ mbyllja/riorganizimi i institucioneve të arsimit të lartë, si detyrim ligjor në varësi të kërkesave të subjekteve të interesuara	Projektvendimi ka për qëllim hapjen/ mbylljen/riorganizimin e institucioneve të arsimit të lartë, sipas kërkesave të subjekteve të interesuara, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”	Jo	Po. Fusha e arsimit	Jo	Po ka efekte ekonomike dhe financiare. Ka efekte mjedisore, pasi hapja e IAL-ve sjell si rezultat ndërtimin e godinave të reja ku do të ushtrohet veprimtaria e tyre. Ka efekte sociale për studentët.
17	“Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit” (rast pas rasti, sipas nevojave)	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori i tretë	Shpërndarja e fondeve për të mbuluar aktivitete të paplanifikuara apo situata emergjente	Projektvendimi ka si synim rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të mbuluar aktivitete të paplanifikuara apo situata emergjente.	Jo	Po. Fusha e arsimit dhe Sportit	Jo	Po ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.



PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA E BRENDSHME

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër- mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës Nëse përputhet, të jepet referencia e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, ‘Për armët’“	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektakt propozohet me qëllim përputhshmërinë dhe zbatimin e përcaktimeve të vendimit nr. 754, datë 09.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit të Veprimit 2022-2024, të strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024”.	Ky projektakt propozohet me qëllim përputhshmërinë dhe zbatimin e përcaktimeve të vendimit nr. 754, datë 09.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit të Veprimit 2022-2024, të strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024”.	Jo	Përputhet me Prioritetet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024, si dhe Plan i Veprimit 2022-2024	Jo
2	“Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të policisë së burgjeve, të policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektligj parashikon trajtimin suplementar të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 9 dhe të nenit 76, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Ky projektligj parashikon trajtimin suplementar të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 9 dhe të nenit 76, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore Lufta kundër korrupsionit	Përputhet me Prioritetet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023 II.2. Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po
3	“Për miratimin e formatit të aktit administrativ që vendos masën administrative dhe llojit të masave që përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektvendim propozohet me qëllim miratimin e formatit të aktit administrativ të masave, gjobave, sanksioneve të parashikuara nga ligji	Miratimi i formatit të aktit administrativ të vendosur nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, për masat administrative të parashikuara në nenin 141 të ligjit, si dhe	Jo	Përputhet me Prioritetet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo



						përcaktimi masave administrative, që përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes së të huajit, referuar autorizimit ligjor të nenit 6.				
4	“Për fondet dhe mënyrën e administrimit të fondeve për qëndrimin në një territor të caktuar”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektvendim parashikon mënyrën e administrimit të fondeve që lidhen me qëndrimin e detyrueshëm në një territor të caktuar për shtetasit e huaj, subjekte të dëbimit ose jo nga RSH.	Ky projektvendim do të rregullojë situatën ligjore të shtetasve të huaj, subjekt të qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar, pas daljes nga Qendra e Mbyllur ose për arsye humanitare. Akti përcakton mënyrën e administrimit të fondeve, trajtimin e shtetasve të huaj, të drejtat socio-ekonomike siç mundësia për të hyrë në marrëdhënie kontraktore pune.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
5	“Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit të të huajit, lejes së kalimit, letërnjoftimit, dublikatës, si dhe formatit të dokumentit të përkohshëm”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektvendim parashikon miratimin e dokumenteve të ndryshëm për të huajit, të lëshuara nga autoriteti shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin.	Nëpërmjet këtij projektakti do të miratohen forma dhe formate të dokumenteve si: dokumenti i udhëtimit të të huajit pa shtetësi, letërnjoftimit, dublikatës së lejes së qëndrimit dhe lejes unike në rastet kur humbet, dëmtohet apo bëhet e pavlefshme, lejes së kalimit, si dhe dokumentit të përkohshëm në rastet e humbjes, dëmtimit të dokumentit të udhëtimit dhe lejes së kalimit	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo
6	“Për përcaktimin e procedurave të trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektvendim parashikon procedurat e trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës.	Ky projektvendim do të rregullojë procedurën e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, në zbatim të nenit 48, pika 1, shkronja “B”.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
7	“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kundër Terrorizmit dhe	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kundër Terrorizmit dhe Ektremizmit.	Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kundër Terrorizmit dhe Ektremizmit.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo



	Ektremizmit (AKTE)									
8	“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të fitimit të shtetësisë në kuadër të programit të investimit ekonomik”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Ky projektvendim përcakton kriteret dhe procedurat e fitimit të shtetësisë në kuadër të programit të investimit ekonomik, në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”.	Ky projektvendim përcakton kriteret dhe procedurat e fitimit të shtetësisë në kuadër të programit të investimit ekonomik, në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”.	Jo	Përpulhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo
9	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit’, i ndryshuar”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Përmirësimi në vlera i pagës bazë për gradë për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si dhe diferencimi në vlera të shtesës për natyrë të veçantë pune, sipas funksioneve korresponduese dhe strukturës së shërbimit qendror dhe vendor të MZSH-së. Miratimi i këtij projektakti diktohet edhe nga nevoja për të përmirësuar vlerat e pagës në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, sepse aktualisht struktura e shërbimit zjarfikës trajtohen shumë më pak se çdo strukturë tjetër, çka nuk reflekton detyrimin ligjor të përcaktuar gërmën “a” të nenit 31 të ligjit nr. 152/2015, ku është sanksionuar se, punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në ligj.	Projektakti përmirëson vlerat e pagës nëpërmjet ndryshimit në strukturën e niveleve të pagave për gradë për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, sipas hierarkisë së gradave dhe niveleve në të cilat janë të përfshira gradat e tyre, lidhur me Lidhjen nr. 1, të VKM nr. 350, datë 19.04.2017, i ndryshuar, si dhe lidhjes nr. 2, ku janë përcaktuar funksionet korresponduese sipas strukturës të shërbimit qendror dhe vendor të MZSH-së, si dhe identifikimi i niveleve të shtesës për natyrë të veçantë pune, sipas vështirësive të këtyre funksioneve të këtij shërbimi.	Jo	Përpulhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
10	Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i parë	Strategjia për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit është një dokument strategjik i	Strategjia e re do të zgjerohet duke vendosur në fokus të saj dhe proceset e rehabilitimit dhe	Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria	Programi Qeverisës 2021-2025-Shqipëria e sigurt. Angazhimi “Ashpërsimi i	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015- 2020); Plani Kombëtar i Veprimit për Integrim Evropian 2021-2023; Strategjia e Sigurisë Kombëtare	Po/sociale



	Radikalizimit 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024				miratuar në vitin 2015 me një afat veprimi të pacaktuar. Koncepti bazë i kësaj strategjie është veprimi apo ndërveprimi institucional me qëllim arritjen e efikasitetit maksimal në procedurat që duhet të ndiqen dhe masat që duhet të merren nga strukturat përkatëse shtetërore në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Nisur nga përvoja e përfutur gjatë vënies në veprim të strategjisë aktuale është parë nevoja për përshtatjen e saj me dinamikat dhe sfidat e kohës duke parë si të pashmangshme nevojën për rishikim dhe ridimensionim të saj, duke filluar me zgjerimin e koncepteve bazë që ajo trajton. Gjithashtu, përcaktimi i një afati kohor të zgjatjes së strategjisë së re të rikonceptuar, është parë si një domosdoshmëri për arritjen e qëllimit primar, përshtatshmëria e saj me kohën, njerëzit, planin e veprimit, si dhe mënyrat dhe procedurat që duhet të ndiqen për zbatimin e saj.	riintegritimit, si dhe propagandën ekstremiste <i>online</i> , faktorë këto që nuk janë përfshirë në strategjinë aktuale. Gjithashtu në fokusin e saj do të vazhdojë të jetë dhe qëndrueshmëria në komunitet për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm identifikimin dhe trajtimin e tyre në kohë.		luftës kundër krimit dhe rritja e kapaciteteve të strukturave nëpërmjet fillimit të punës për miratimin e Kodit të ri Penal”	(2016-2020); Strategjia Ndërsëktoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023; Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021- 2022; Strategjia Ndërsëktoriale e Sigurisë në Komunitet 2021- 2026 dhe Plani i Veprimit 2021- 2023; Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2021-2026; Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2020-2025; Strategjia për Edukim Ligjor të Publikut 2019- 2023; Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023 dhe Plani i Veprimit në zbatim të saj; Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e tij; Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj; Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj; Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025; Marrëveshje ndërkombëtare Protokoli i bashkëpunimit me Maqedoninë e Veriut (2019) dhe Plani i Përbashkët i Veprimit në Luftën kundër Terrorizmit; Plani i Përbashkët i Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian; Marrëveshje me EUROPOL, INTERPOL, Konventa kundër krimit të organizuar trans-nacional etj. Prioritetet e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit 2022- 2023; Strategjia Globale e kombeve të Bashkuara, Konventat dhe protokollat e Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit; Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e Terrorizmit.	
11	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, 'Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikëve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë', i ndryshuar”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Përmirësimi i dispozitave ligjore aktuale.	Përmirësimi i dispozitave ligjore aktuale.	Jo	Përpulthet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo
12	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34,	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Përmirësimi i dispozitave ligjore	Përmirësimi i dispozitave ligjore	Jo	Përpulthet me Prioritet e Ministrisë së	Nuk ka	Jo



	datë 4.07.2019, 'Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara', i ndryshuar"				aktuale.	aktuale.		Brendshme të vitit 2023		
13	"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2014, 'Për Policinë e Shtetit', i ndryshuar"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Projektligji synon rregullimin e disa procedurave që lidhen me personelin e Policisë së Shtetit, dhe statusin e tyre, procesin e miratimit të strukturës së Policisë së Shtetit, rregullimin e disa përkufizimeve me qëllim qartësimin dhe saktësimin e kuptimit të tyre, shfuqizimin e disa dispozitave si pasojë e mosimplementimit të tyre, ndryshimin e disa kritereve të emërimit dhe lirimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Zëvendësrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, saktësimin e disa strukturave në Policinë e Shtetit, procedurat për fitimin e gradës, masat disiplinore etj.	Rregullimi i procedurave që lidhen me personelin e Policisë së Shtetit, dhe statusin e tyre, procesin e miratimit të strukturës së Policisë së Shtetit, rregullimin e disa përkufizimeve me qëllim qartësimin dhe saktësimin e kuptimit të tyre, shfuqizimin e disa dispozitave si pasojë e mosimplementimit të tyre, ndryshimin e disa kritereve të emërimit dhe lirimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Zëvendësrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, saktësimin e disa strukturave në Policinë e Shtetit, procedurat për fitimin e gradës, masat disiplinore.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
14	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 348, datë 29.04.2015, 'Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorisë "B" dhe "C", në territorin e Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Ky projektakt propozohet me qëllim përputhshmërinë dhe zbatimin e përcaktimeve të vendimit nr. 754, datë 09.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit të Veprimit 2022-2024, të strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024".	Ky projektakt propozohet me qëllim përputhshmërinë dhe zbatimin e përcaktimeve të vendimit nr. 754, datë 09.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit të Veprimit 2022-2024, të strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024".	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019-2024, si dhe Plani i Veprimit 2022-2024	Jo
15	"Për përcaktimin e kohëzgjatjes e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës dhe kohëzgjatjes së ruajtjes së banesës së personaliteteve të tjera"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Ky projektvendim parashikon kohëzgjatjen e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës, në zbatim të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr.	Ky projektvendim parashikon kohëzgjatjen e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës, në zbatim të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo



					33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së banesës së personaliteteve të tjera, në zbatim të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së banesës së personaliteteve të tjera, në zbatim të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.				
16	“Për përcaktimin e masës ditore të përfutimit dhe procedurën e kompensimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Ky projektvendim përcakton masën ditore të përfutimit dhe procedurën e kompensimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Ky projektvendim përcakton masën ditore të përfutimit dhe procedurën e kompensimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
17	“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për transferimin e punonjësve në struktura të tjera me gradë”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Ky projektvendim përcakton rregullat dhe procedurat për transferimin e punonjësve në struktura të tjera me gradë, në zbatim të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Ky projektvendim përcakton rregullat dhe procedurat për transferimin e punonjësve në struktura të tjera me gradë, në zbatim të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo
18	“Për përcaktimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelin e dokumentit individual të identifikimit të Policisë Bashkiake”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Akt nënligjor në zbatim të ligjit, “Për Policinë Bashkiake”.	Me qëllim unifikimin dhe standardizimin e uniformave dhe automjeteve, me shenjat dalluese, ngjyrën, që do të përdorë policia bashkiake, duke mbajtur parasysh specifikën e çdo bashkie.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023 3. Shërbimet publike	Nuk ka	Jo
19	“Për përdorimin e mjeteve lëvizëse motorike të Policisë Bashkiake e përcaktimin e ngjyrës dhe të shenjave dalluese të tyre”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i dytë	Akt nënligjor në zbatim të ligjit, “Për Policinë Bashkiake”.	Me qëllim unifikimin, standardizimin dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të mjeteve lëvizëse motorike të Policisë Bashkiake, me shenjat dalluese, ngjyrën, duke mbajtur parasysh specifikën e çdo bashkie.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023 3. Shërbimet publike	Nuk ka	Jo



20	“Për trajtimin shëndetësor dhe sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ky projektvendim parashikon shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe përfituesit, në zbatim të pikës 3, të nenit 71, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Ky projektvendim parashikon shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe përfituesit, në zbatim të pikës 3, të nenit 71, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore Lufta kundër korrupsionit	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023 II.2. Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po
21	“Për trajtim të veçantë për strehim dhe qira banese të të punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ky projektvendim parashikon kriteret për përfitim të kredisë për strehim dhe masën e saj, si dhe kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së qirasë për strehim, të punonjësit të agjencisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 72 dhe të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Ky projektvendim parashikon kriteret për përfitim të kredisë për strehim dhe masën e saj, si dhe kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së qirasë për strehim, të punonjësit të agjencisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 72 dhe të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore Lufta kundër korrupsionit	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023 II.2. Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po
22	“Për mbrojtjen e veçantë të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore trajtimin e familjarëve të punonjësve të Agjencisë, që humbin jetën për shkak të detyrës”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ky projektvendim parashikon kushtet dhe mënyrën e mbrojtjes së veçantë për punonjësit e Agjencisë, që u kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës, në zbatim të pikës 2, të nenit 75, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, si dhe rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve të Agjencisë, që humbin jetën për shkak të detyrës, në zbatim të pikës 2, të nenit 77, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Ky projektvendim parashikon kushtet dhe mënyrën e mbrojtjes së veçantë për punonjësit e Agjencisë, që u kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës, në zbatim të pikës 2, të nenit 75, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, si dhe rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve të Agjencisë, që humbin jetën për shkak të detyrës, në zbatim të pikës 2, të nenit 77, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.	Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore Lufta kundër korrupsionit	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023 II.2. Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po
23	“Për trajtimin e punonjësit me ndihmë financiare në rastet e fatkeqësive në	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ky projektvendim përcakton procedurat e trajtimit financiar gjatë	Ky projektvendim përcakton procedurat e trajtimit financiar gjatë	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit	Nuk ka	Po



	familje, trajtimin e punonjësit me ndihmë financiare në masën e tri pagave mujore, trajtimin e punonjësit me ndihmë të menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private për shkak të detyrës”				qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, në rastet e fatkeqësive në familje, procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, për shpërblimin deri në masën e tri pagave mujore, procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, për ndihmë të menjëhershme financiare, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit, në zbatim të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, në rastet e fatkeqësive në familje, procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, për shpërblimin deri në masën e tri pagave mujore, procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, për ndihmë të menjëhershme financiare, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit, në zbatim të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	2023			
24	“Për sigurimin shëndetësor të veçantë, të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ky projektvendim përcakton shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe strukturat e veçanta që përfitojnë, në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Ky projektvendim përcakton shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe strukturat e veçanta që përfitojnë, në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Jo	Përpulthet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
25	“Për trajtimin me kredi të butë të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ky projektvendim përcakton kriteret, masën e përfitimit, interesat dhe procedurën për fitimin dhe ndërprerjen e kredisë me interesa të buta, në zbatim të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Ky projektvendim përcakton kriteret, masën e përfitimit, interesat dhe procedurën për fitimin dhe ndërprerjen e kredisë me interesa të buta, në zbatim të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	Jo	Përpulthet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po



26	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10123, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ligji ka nevojë për rishikim në të gjithë nenet e vendbanimit dhe shërbimit të gjendjes civile ndaj shtetasve, në vijim të kalimit të shërbimeve <i>online</i> .	Ky projektvendim synon të rregullojë mënyrën e ofrimit të shërbimeve të gjendjes civile ndaj shtetasve, në vijim të kalimit të shërbimeve publike <i>online</i> .	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo
27	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Ligji ka nevojë për rishikim në nenet e përcaktimit të Regjistrat Kombëtar të Adresave, ndërlidhjes me institucione të tjera. Po ashtu është i nevojshëm rishikimi i akteve nënligjore për sinjalistikën e adresave.	Propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 synohen të realizohen përmes rishikimit kryesisht të parashikimeve për Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA), sa i takon adresimit të të gjithë ndërtesave shtetërore, konkretisht përmes: -Ndërtimit të regjistrat të ndërtesave në RKA; -Detyrimit të institucioneve për deklarimin e adresës në RKA; -Ndërtimit të regjistrat të institucioneve në RKA. Gjithashtu, synohet shtimi i pikave të interesit në RKA, përmes: -Propozimit të ndryshimeve ligjore për detyrimin e zyrave të urbanistikës për vendosjen e pikave të interesit; -Ndërtimit të regjistrat të pikave të interesit për të regjistruar spitalet, rajonet e policisë, bashkitë, muzetë etj; -Regjistrimit të institucioneve të emergjencave në RKA (Policia, Zjarrfikësja, Spitale etj).	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo
28	“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Në vijim të përfundimit të periudhës kohore të zbatimit të strategjisë aktuale, lind nevoja për hartimin e strategjisë së	Në vijim të përfundimit të periudhës kohore të zbatimit të strategjisë aktuale, lind nevoja për hartimin e strategjisë së	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Jo



					re dhe planit të veprimit. Neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.	re dhe planit të veprimit. Neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.				
29	“Për funksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Projektligji, “Për funksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike”, synon të arrijë këto objektiva: - Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet; - Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe mes institucioneve të ndryshme me rol dhe përgjegjësi për sigurinë në komunitet; - Përmirësimi i sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe nëpërmjet proaktivitetit institucional; - Rritja e përfshirjes dhe e mbështetjes së njësisë të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike; - Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sigurisë ndaj komunitetit nga ana e strukturave përgjegjëse; - Përmirësimi i komunikimit me publikun.	Projektligji, “Për funksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike”, synon të arrijë këto objektiva: - Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet; - Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe mes institucioneve të ndryshme me rol dhe përgjegjësi për sigurinë në komunitet; - Përmirësimi i sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe nëpërmjet proaktivitetit institucional; - Rritja e përfshirjes dhe e mbështetjes së njësisë të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike; - Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sigurisë ndaj komunitetit nga ana e strukturave përgjegjëse; - Përmirësimi i komunikimit me publikun.	Jo	Përpulhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.12.2020, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe të planit të veprimit 2021–2023”.	Jo
30	“Për disa ndryshime në ligjin nr. 107/2016, Për Prefektin e Qarkut”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Përmirësimin e ligjit organik duke qartësuar dhe rritur rolin e prefektit të qarkut.	Projektligji ka si qëllim rritjen e rolit të prefektit të qarkut duke saktësuar mënyrën e verifikimit të realizimit të funksioneve nga ana e pushtetit vendor, të përgjegjësisë të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione.	Jo	Përpulhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Ndërthuret me Strategjinë e Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Vendore	Jo



31	“Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori i tretë	Nevoja për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve.	Ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, përcaktimi i mënyrës së funksionimit, kompetencave dhe përgjegjësi të kësaj zyre, si dhe mënyra e bashkëpunimit me institucionet e tjera, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj.	Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria	Përputhet me Prioritetin e Ministrisë së Brendshme të vitit 2023	Nuk ka	Po
----	--	-------------	----------------------	---------------------	--	---	---	--	--------	----

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2023	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Vendimi miratohet çdo vit bazuar në buxhetin e alokuar për programin për bujqësinë dhe zhvillimin rural si masë e mbështetjes direkte për fermerët.	Përcakton masat, kriteret dhe mbështetjen për bujqësinë, përfshirë dhe për punime të mekanizuara, në Skemat Kombëtare dhe buxhetit të shtetit për vitin 2023, sipas buxhetit që miratohet vitin 2023.	Jo	Rritja e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore; Përmirësimi i zinxhrit të sigurisë ushqimore; Nxitja e formalizimit përmes kooperimit bujqësor; Nxitja e kultivimit të tokës së papunuar; Mbështetja e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.	SBZHRP 2021-2027	Po, ka, buxheti i parashikuar për vitin 2023 për MBZHR-në.
2	Për ndryshimin e zërit kadastral nga toke bujqësore në tokë urbane truall për sipërfaqen 60.2 metër katror, në Bashkinë Memaliaj	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Me kalimin në toke truall krijohet mundësia e ndërtimit të një magazine bujqësore	Akt me karakter teknik për lejimin e ndërtimit të një magazine bujqësore.	Jo	Jo	Jo	Jo
3	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Lehtësimi i kriterëve dhe procedurave për certifikimin e subjekteve që aplikojnë dhe ushtrojnë aktivitet agroturizmi.	Projektakti rregullon çështje që lidhen me sipërfaqen e tokës që duhet të ketë një subjekt agroturistik, integrimin e bletarisë dhe nënsektorëve të tjerë në agrotizëm, nëpërmjet qartësimit të procedurave dhe	Jo	Po, zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit (nxitje dhe rritje e agroturizmit)	SBZHRP 2021-2027	Nuk ka



	funkcion të tij”, të ndryshuar					knitereve.				
4	Projektvendi, “Për miratim në parim të marrëveshjes së zbatimit për projekte të bashkëpunimit teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë nga MBZHR-ja Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë përfaqësuar nga DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT (GIZ) GMBH	Projektvendi	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Nëpërmjet këtij projektvendi do të miratohet në parim shtimi i masave vijuese të projektit të miratuar sipas marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë,	Synohet të arrihet një transformim ekonomik i zonave rurale në Shqipëri, i cili është i vlefshëm për popullsinë vendase, duke përfshirë të kthyerit nga emigracioni, konkretisht:	Jo	Jo	SBZHRP 2021-2027	Nuk ka
5	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore	Projektvendi	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Përcakton qëllimin, vizionin dhe synimet në çështjet e sigurisë ushqimore.	Do të përcaktojë qartë përfshirjen e autoriteteve publike dhe subjekteve private me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore në Shqipëri, planin e veprimit për 7 vitet e ardhshme dhe masat konkrete që parashikohet të zbatohet.	Po (nuk ka tabela përputhshmërie)	Po	SBZHRP 2021-2027	Nuk ka
6	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së të fondit të tokës bujqësore aktualisht në pronësi të shtetit	Projektvendi	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Kalimi në administrim të disa pronave në MBZHR	Akt me karakter teknik që kalon në administrim tokat bujqësore të MBZHR-ja.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka
7	Për caktimin e ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural si organ përgjegjës për realizimin e procedurës së deratizimit të bimës së gështenjes, me qëllim mbrojtjen e saj nga parazitët grerëza galeformuese (<i>dryocosmus kuripbilus hymenoptera: cynipidae</i>)	Projektvendi	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Caktimi i MBZHR si Autoritet Kontraktor, për prokurimin e fondeve buxhetore, për trajtimin dhe mbrojtjen e gështenjes nga parazitët grerëza Galeformuese (<i>Dryocosmus Kuripbilus Hymenoptera: Cynipidae</i>).	Vijimi i luftës kundër parazitit <i>Grerëza galeformuese</i> .	Jo	Po	SBZHRP 2021-2027	Po, ndikime ekonomike dhe sociale
8	Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 113/2015, “Për urdhrin profesional të mjekut veterinar”.	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Funksionimi i Urdhrit të Mjekut Veterinar nuk garanton kryerjen e funksioneve me cilësinë e duhur dhe rregullimet	Unifikim i praktikave që ndiqen nga Urdhri i Mjekut Veterinar me entitete të tjera të ngjashme. Rregullime të karakterit organizativ të urdhrin.	Jo	Nuk ka referencë në programin politik	Nuk ka lidhje me Strategjinë	Nuk ka
9	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe	Katërmujori II	Ligji duhet përditësuar bazuar në ecurinë e	Rregullime të karakterit teknik dhe	Jo	Nuk ka reference në programin politik	Nuk ka lidhje me Strategjinë	Nuk ka



	9244/2004, “Për mbrojtjen e tokës”.		Zhvillimit Rural		legjislationit në tërësi.	përditësimi i ligjit.				
10	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8752/2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Ligji duhet përditësuar në harmoni me ndryshimet në Ligjin nr. 9244/2004.	Rregullime të karakterit teknik.	Jo	Nuk ka reference në programin politik	Nuk ka lidhje me Strategjinë	Nuk ka
11	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10416/2011, “Për materialin mbjellës shumëzues bimor.	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Në praktikë gjatë vitit 2022 ka pasur shqetësime nga fermerët dhe subjektet tregtare për vakum ligjor dhe rregullime që duhet përditësuar. Po ashtu nga ESHIF ka sugjeruar ndryshime ligjore të karakterit teknik.	Projektligji do të përmirësojë procesin e testimit të farave, fidanëve dhe varieteteve me qëllim garantimin e rritjes së cilësive të tyre dhe prodhimit bujqësor për konsum dhe eksport.	Jo	Rritja e eksporteve.	SBZHRP 2021-2027	Nuk ka
12	Për organizimin e Inspektoratit të peshkimit	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Ky akt ka për qëllim të organizojë Inspektoratin e Peshkimit sipas standardeve të BE-së duke siguruar kontrollin efektiv, inspektimin dhe zbatimin e rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit në bashkëpunim dhe me vendet e treta.	Përcakton organizimin dhe funksionimin e inspektoratit	Po	Jo	SBZHRP 2021-2027	Nuk ka
13	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 347, datë 22.5.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private”	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Përmirësimi i vendimit në fuqi dhe përshtatja me konkurrimin elektronik, krijimi i mundësisë së subjekteve private të konkurrojnë dhe për rrjedhojë efektiviteti i shfrytëzimit të aseteve në sektorin e peshkimit.	Përcaktimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe infrastrukturës së peshkimit si asetet që transferohen	Jo	Jo	jo	Nuk ka
14	Për miratimin e rregullave për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim nga ligji 17/2020, “Për produktet plehëruese”.	Përcaktimi rregullave për prodhimin dhe veprimtaritë e tjera që lidhen me produktet plehëruese.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka
15	Për tarifën e shërbimeve e të analizave, që kryhen nga laboratorët i referencës dhe laboratorët e miratuar	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim nga Ligji 17/2020, “Për produktet plehëruese”.	Përcakton vlerën e tarifave të analizave që aplikohen nga laboratorët.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka



16	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465/2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Rregullime të karakterit teknik që lidhen me funksionimin e institucioneve në harmoni me ligjet që do përafrohen.	Rregullime të karakterit teknik që lidhen me funksionimin e institucioneve në harmoni me ligjet që do përafrohen.	Jo	Po	Jo	Po
17	Për miratimin e Marrëveshjes së Financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, në emër të Bashkimit Evropian, për IPARD III 2021 - 2027, Asistenca për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, IPA III	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Akti krijon kushtet e aplikimit të IPARD III.	Akti krijon kushtet e aplikimit të IPARD III.	Jo	Po	SBZ/HRP 2021-2027	Po: Efekte ekonomike, sociale

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
1	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i parë	Miratimi i këtij projektligji diktohet nga problematikat e hasura në praktikë mbi funksionimin me kapacitet të plotë të Policisë së Burgjeve, për shkak të vakancave të krijuara dhe nevojës për të garantuar ruajtjen e rendit dhe sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.	Në këtë projektligj synohet të përcaktohen kriteret për kalimin në gradë si dhe kriteret ndalues për pranimin në Policinë e Burgjeve. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projektligji synohet rregullimi i pranimit me përparësi i punonjësve të liruar nga Policia e Burgjeve më parë, apo nga institucionet e tjera ligjzbatuese.	JO	JO	JO	PO
2	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i parë	Përmirësimi dhe forcimi i rregullave dhe procedurave të legjislacionit aktual për të drejtën e informimit, duke pasur në fokus nga njëra anë interesin e qytetarëve për të ushtruar të drejtën për informim lidhur me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe nga ana tjetër rritjen e transparencës dhe llogaridhënies	Përmirësimi i legjislacionit ekzistues. Parashikimi i kompetencave të Komisionerit në fushën e të drejtës për informim, në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”. Garantimi i të drejtës për informim i personave me aftësi të kufizuar. Detyrimi për përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës çdo herë që pëson ndryshime. Rregullimi	JO	JO	JO	PO



					së autoriteteve publike. Po ashtu, nevoja për ndryshim ka ardhur dhe si pasojë e hartimit të legjislacionit të ri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kompetencat e Komisionerit në fushën e të drejtës për informim, të parashikuar në ligjin aktual për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk do të jenë pjesë e ligjit të ri, por do të vendosen në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”.	i përgjegjësisë në raste shkelje të ligjit, si dhe i sanksioneve përkatëse.				
3	Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i parë	Rekomandimet kanë për qëllim dhe synojnë garantimin e funksionimit efektiv të organit të prokurorisë, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, kimit të organizuar, dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut.	Përcaktimin e prioritetëve në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, në pëmbushje të detyrimeve të brendshme ligjore, si dhe rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare. Këto rekomandime prioritare i përcillen organit të prokurorisë në ushtrim të përgjegjësisë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve.	JO	JO	JO	JO
4	Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022-2025	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i parë	Planifikimi, buxhetimi dhe monitorimi i politikave në fushën e drejtësisë penale për të mitur. Gjithashtu, synimi kryesor është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të të miturve në proceset gjyqësore, alternativat ndaj këtyre procedurave për të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit viktimë apo dëshmitar të veprave penale.	Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi, procesi i rregullt ligjor për të miturit, integritet dhe përfshirje sociale e të miturve në konflikt me ligjin, rritje e kapaciteteve të strukturave të sistemit të drejtësisë për të mitur.	JO	JO	JO	JO
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 110, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i parë	Projektvendimi synon përfaqësimin e projektaktit me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit në praktikë të tij.	Ndryshimet në vendimin nr. 110, datë 06.03.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” synojnë garantimin e përputhshmërisë së dispozitave të tij me KPA-në. Konkretisht, synohet rishikimi i afatit që ka komisioni vlerësues për shqyrtimin e kërkesave, vlerësimin e pëmbushjes së kriterëve të përgjithshme	JO	JO	JO	JO



	juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre					dhe të veçanta, si dhe caktimin e masës financiare. Gjithashtu, projektvendimi përcakton metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse mbi bazën e së cilës komisioni të vlerësojë kërkesat përkatëse.				
6	Për disa shtesa në vendimin nr. 330, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore ‘Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS’”	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i parë	Miratimi i këtij projektvendimi është i domosdoshëm në kuadër të masave të ndërmara për mbrojtjen e sigurisë së informacionit dhe të dhënave që përmban Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS.	Ky projektakt ka për qëllim të përcaktojë rregulla që parashikojnë mbrojtjen e të dhënave që përmban Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS, i krijuar përmes vendimit objekt ndryshimi, nëpërmjet përcaktimit të një niveli sigurie që siguron enkriptimin e të dhënave që ruhen në këtë sistem. Gjithashtu, synohet garantimi i sigurisë së informacionit duke parashikuar rregulla për aksesimin e sistemit nga subjektet e interesuar sipas përcaktimeve të këtij vendimi.	JO	JO	JO	JO
7	Për mbrojtjen e të dhënave personale	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Harmonizimi me <i>acquis</i> e BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680”, si dhe zbatimi i standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Përmirësimi i rregullave për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre.	Garantimi i standardeve më të larta evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave personale në epokën digjitale është shumëfishuar. Qytetarëve u garantohej një nivel më i lartë kontrolli mbi të dhënat e tyre personale. Krijimi i një kuadri ligjor gjithpërfshirës, duke garantuar edhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e të dhënave nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla	PO	JO	PKIE	PO
8	Për Agjencinë e Mbrojtjes në Sistemin Penitenciar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Ky projektligj synon riorganizimin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burjeve në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit penitenciar në Republikën e Shqipërisë. Forcimi i këtij institucioni mbikëqyrës synon të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në burje.	Ky projektligj përcakton rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbrojtjes në Sistemin Penitenciar në Republikën e Shqipërisë në tërësinë e tij, i cili do të zëvendësojë Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burjeve, si organi përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.	JO	JO	JO	PO
9	Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin, shpërbimin dhe	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Miratimi i këtij projektvendimi është diktuar nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtarë”	Në këtë projektvendim do të përcaktohen kriteret dhe rregullat për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërbimin e përkthyesve zyrtarë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve që ligji u ka njohur të drejtën	JO	JO	JO	JO



	mënyrën e kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë					për përkthimin zyrtar të akteve ose dokumenteve, si dhe mënyrën e kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë.				
10	Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesave për të vepruar si administrator, procedurën për dhënien dhe heqjen e licencës, si dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Projektakti propozohet me qëllim përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesave për administrator të falimentit, licencimin e administratorëve të falimentit, heqjes së licencës dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre.	Projektakti synon të përcaktojë rregullat mbi licencimin e administratorëve të falimentit.	JO	JO	JO	JO
11	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 222, datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj”	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Projektakti propozohet në kuadër të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen “Beshiri kundër Shqipërisë” dhe vendimin nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.	Projektakti i propozuar ka si synim zbatimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 133/2015 lidhur me përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar.	JO	JO	JO	PO
12	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 223, datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i dytë	Projektakti propozohet në kuadër të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen “Beshiri kundër Shqipërisë” dhe vendimin nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.	Projektakti i propozuar ka si objektiva: - Zbatimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 133/2015 lidhur me përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar. - Zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë zbatimit të VKM-së nr. 223/2016.	JO	JO	JO	PO
13	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Projektligji synon ofrimin e zgjidhjeve më optimale për të garantuar interesin më të lartë të miturit, si dhe rritjen dhe edukimin e tij në një mjedis familjar sa më të përshtatshëm për të, kur familja biologjike nuk ka mundësi t'i ofrojë një mjedis të tillë.	Ky projektligj ka si qëllim rregullimin e kushteve dhe procedurave ligjore që ndiqen për birësimin e të miturit, që kanë të bëjnë kryesisht me: • Çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të birësimit (moshën e birësuesit dhe të birësuarit dhe diferencën e moshës ndërmjet tyre, statusin e birësuesit);	JO	JO	JO	PO



						- deklarimin e braktisjes të të miturit; - dhënien e pëlqimit për birësim nga palët e përfshira në birësim (birësuesi, bashkëshorti nëse aplikon për të birësuar vetëm njëri nga bashkëshortët, prindërit biologjikë të të miturit që do të birësohet dhe vetë i miturit); - përshtatshmërinë e aplikantit birësues për t'u kujdesur për rritjen dhe edukimin e fëmijës që do të birësohet; - gjykimin e birësimit dhe traskriptimin e vendimit të gjykatës; - birësimet ndërvendase dhe kufizimet përkatëse etj.				
14	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Qëllimi i këtij projektligji është reformimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor në fuqi në fushën e birësimit. Problemet që kanë lindur në praktikën e Komitetit Shqiptar të Birësimit dhe në praktikën gjyqësore shqiptare kanë diktuar ndjeshëm nevojën për ndryshime të mëtejshme në legjislacionin që rregullon procedurën e birësimit. Pas analizës së posaçme të përmbajtjes së ligjit nr. 9695, datë 19.3.2007, "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve", të ndryshuar (ligji nr. 9695/2007), u evidentua nevoja për përmirësimin e procedurave të cilat do të lehtësojnë procesin e birësimit, për t'u mundësuar kështu fëmijëve të deklaruar të braktisur një familje, duke siguruar dhe garantuar njëkohësisht interesin më të lartë të tyre (fëmijëve).	Përmes ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj, synohet të ofrohet zgjidhje optimale ndaj disa problematikave që kanë të bëjnë me: - deklarimin e braktisjes së fëmijëve; - kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të birësimit; - harmonizimin e ligjeve të zbatueshme në rastin e birësimit me elementë të huaj; - aspektet organizative të vetë këtij institucioni.	JO	JO	JO	PO
15	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Nëpërmjet këtij projektligji synohet parandalim i posaçëm i për uljen e nivelit të kriminalitetit për krimet e kryera me dashje nga persona të cilët janë dënuar më parë po për një krim të kryer me dashje. Në rastin e krimeve të kryera me dashje nga të dënuarit përsëritës, dënimit të përcaktuar nga dispozita përkatëse i shtohet edhe dënimi shtesë, i cili varet nga lloji i krimit të ri të kryer, kohëzgjatjes mes kryerjes së veprave penale, faktit	Projektligji vendos përcaktime të qarta e të sakta për llojet e recidivizmit, kategorinë e veprave penale ku do të zbatohet përsëritja dhe ashpërsimin e dënimit në varësi të shfaqjes së tij.	JO	JO	JO	JO



					nëse vepra e re penale kryhet para apo pas përfundimit të dënimit të mëparshëm si dhe faktit nëse autori është dënuar më parë si përsëritës në kryerjen e krimeve me dashje.					
16	Për një shtesë në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Ky parashikim vjen në kuadër të parandalimit të përgjithshëm me qëllim uljen e kriminalitetit ndaj fëmijëve dhe dhunës në familje, duke shmangur uljen e dënimit automatik të dënimit. Individualizimi i dënimit i takon gjykatës mbi caktimin e masës së dënimit brenda kufijve ligjorë. Dënimi penal duhet të jetë në funksion të rehabilitimit social të autorëve të këtyre veprave penale dhe ulja e dënimit nuk duhet të jetë një përfutim i padrejtë i cili nuk i shërben drejtësisë penale.	Nëpërmjet këtij projektligji synohet të bëhet shtimi i parashikimit të posaçëm mbi ndalimin e zbatimit të gjyqimit të shkurtuar për personat që kryejnë një veprë penale ndaj fëmijëve që kryejnë dhunë në familje.	JO	JO	JO	JO
17	Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Miratimi i këtij projektligji është diktuar nga problematikat e hasura në praktikë mbi funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe rregullimin e këtij institucioni me akt ligjor dhe jo nënligjor duke rregulluar në mënyrë të detajuar fushën e përgjegjësisë dhe mënyrën e funksionimit të këtij institucioni.	Përmes këtij projektligji synohet të rregullohet mënyra e funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore i cili është një institucion i natyrës së veçantë dhe kërkon organizim të posaçëm.	JO	JO	JO	PO
18	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9754, datë 14.6.2007, "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Miratimi i këtij projektligji diktohet nga nevoja për parashikimin e rregullave të detajuara dhe kritereve lidhur me dënimet e dhëna ndaj personave juridikë të cilët përgjigjen penalisht. Gjithashtu ka lindur nevoja për rishikimin e llojeve të dënimeve të dhëna ndaj personave juridikë.	Ky projektligj synon të parashikojë rregulla të detajuara dhe kritere lidhur me dënimet penale ndaj personave juridikë të cilët përgjigjen penalisht, si dhe llojet e dënimeve të dhëna ndaj personave juridikë.	JO	JO	JO	JO
19	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori i tretë	Miratimi i këtij projektligji diktohet nga nevoja për adresimin e disa çështjeve që janë evidentuar si problematike gjatë zbatimit të ligjit nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar".	Ky projektligj synon të përmirësojë rregullat e ligjit të përkthimit zyrtar, nisur nga implementimi i tij në praktikë dhe problematikat e evidentuara gjatë aplikimit të këtyre rregullave ligjore.	JO	JO	JO	JO



PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për punësimin e anëtarëve të familjes së punonjësve në misionet diplomatike dhe postet konsullore	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori i parë	Interesi i ndërsjellë i palëve për lidhjen e marrëveshjes, që në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” miratohet në parim para nënshkrimit.	Mundësimin e punësimit të familjarëve të të diplomateve në mënyrë reciproke për familjarët diplomatëve të emëruar në dy vendet.	Jo	Po, fusha Konsolidimi i imazhit dhe rolit të Shqipërisë	Jo	n/a
2	Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 e Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori i parë	Përbushjen e detyrimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.	Përditësimin e listës së sanksioneve të shpallura nga Këshilli i Bashkimit Evropian	Po, Kapitulli 31	Po, fusha Integrimi Evropian	Jo	Jo
3	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim në fushën e diasporës	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori i dytë	Miratimi përfundimtar është kusht për hyrjen në fuqi të marrëveshjes në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.	Angazhimin në programe të përbashkëta kulturore për diasporën, shkëmbimin e eksperiencave dhe vizitave në fushën e diasporës	Jo	Po, fusha Mbrojtja e interesave të Shqiptarëve	Jo	Jo
4	Për propozimin e projektligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”	Projektligj	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori i tretë	Synon rritjen e vlerësimit të Moneyval për RSH-në dhe zbatimin e Rekomandimit 7 të FATF nga “pjesërisht i adresuar” në “plotësisht i adresuar”.	Nenin 8 “Blokimi i përkohshëm”; nenin 11 “Organet përgjegjëse”; nenin 12 “Blokimi i aseteve dhe fondeve”; nenin 13 “Lejimi i përdorimit të asteve të bllokuara”; nenin 17 “Publikimi i masave shtrënguese ndërkombëtare”; nenin 18 “E drejta për ankim”	Jo	Po, fusha Konsolidimi i imazhit dhe rolit të Shqipërisë	Jo	n/a
5	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovakisë, për punësimin e familjarëve të diplomateve të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori i tretë	Miratimi përfundimtar është kusht për hyrjen në fuqi të marrëveshjes, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.	Mundësimin e punësimit të familjarëve të të diplomateve në mënyrë reciproke për familjarët diplomatëve të emëruar në dy vendet.	Jo	Po, fusha Konsolidimi i imazhit dhe rolit të Shqipërisë	Jo	n/a
6	Për hapjen/mbylljen e misioneve diplomatike/posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori i tretë	Hapja e përfaqësive në Bosnjë dhe Hercegovinë, Ukrainë dhe Maqedoninë e Veriut (Strugë), me qëllim realizimin e politikës së jashtme të Republikës së	Intensifikimi dhe rritja e marrëdhënieve politike, diplomatike kulturore dhe ekonomike me BiH, Ukrainën, si dhe forcimi i lidhjeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së	Jo	Po, fusha Konsolidimi i imazhit dhe rolit të Shqipërisë Po, fusha Mbrojtja e interesave të Shqiptarëve	Jo	Po



					Shqipërisë nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve diplomatike me këto vende, si dhe funksion të mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë jashtë vendit.	Veriut me shtetin amë.				
--	--	--	--	--	--	------------------------	--	--	--	--

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyeja e nxjerrjes së projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale. Nëse lidhen të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës".	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Qëllimi është të përmirësojë rregullat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e brendshëm për të nxitur eficiencën ekonomike.	1. Mbrojtja e konkurrencës në mënyrë sa më efektive nëpërmjet forcimit të rolit të AK në cilësinë e autoritetit përgjegjës për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg; 2. Sigurimi i mbikëqyrjes efektive të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës nëpërmjet aksesit në sistemet <i>online</i> të agjencive ligjzbatuese;	Jo në PKIE e MFE por në atë të autoritetit të konkurrencës.	Jo	Po me Politikën Kombëtare të Konkurrencës	Po
2	Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të pakthyera.	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	AMGKP është ligj i ri që shfuqizon ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", duke qenë një ligj i vjetër në kohë, dhe ka si qëllim krijimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive shtetërore të huas dhe të kthimit të tyre, njëkohësisht edhe funksionet aktuale për trajtimin e kredive të cilat do të vijojnë të kryen nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera.	Agjencia do ketë si funksion menaxhimin e skemave të veçanta të garancive të huas; kthimin e garancive shtetërore të huas; kthimin e huave dhe nënhuave të garantuara nga ministri përgjegjës për financat; verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse që kanë përfituar nga garancitë, huat dhe nënhuatë të garantuara nga ministri përgjegjës për financat; trajtimin e kredive, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësish shtetëror mbas privatizimit të tyre; trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG sh.a. para privatizimit të saj.	Jo	Jo	Jo	Po
3	Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Rishikimi i strukturës organizative të DPM dhe ISHMT (bashkimi i dy institucioneve).	Me bashkimin e dy institucioneve rakordimi i informacioneve të marra dhe kryerja e inspektimeve do të ishte më efektive në kuadër të përbushjes së detyrave funksionale të institucionit.	Jo	Jo	Jo	Jo
4	Për disa shtesa dhe	Projektvendim	Ministri i	Katërmujori	Projektvendimi ka për qëllim	Përfuturi i bursës së plotë ose të	Jo	Ky projektvendim është në	Strategjia	Ky projektakt prodhon ndikim



	ndryshime në vendimin me nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfutimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.		Financave dhe Ekonomisë	i parë	dhënie e bursës për nxënësit e arsimit të mesëm profesional të cilët pëmbushin kriterin e rezultateve të arritura, kriterin joekonomik, kriterin e degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, pavarësisht nëse familjet e tyre ushtrojnë apo jo veprimtari private.	pjesë nga nxënësit që plotësojnë kriterin e rezultateve të arritura, kriterin joekonomik, kriterin e degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, pavarësisht nëse familjet e tyre ushtrojnë apo jo veprimtari private		përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, ku një ndër prioritetet e qeverisë për vitin 2022-2024 është rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor, ndjekja e arsimit bazë dhe të mesëm si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerabël.	Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 . Plani i Optimizimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional, miratuar në Qershor 2022.	financiar për buxhetin e shtetit.
5	Për kriteret e hapjes, mbylljes, riorganizimit të ofruesve të AFP-së.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Riorganizimi i Institucioneve Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional, në kuadër të zbatimit të procesit të Optimizimit.	Përcaktimi i kritereve për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Qendrave Shumëfunktionale	Jo	Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave 2021-2025, në lidhje me reformën në arsimin profesional, i cili ka në fokus investimin në një rrjet të mirëfilltë shkollash modeme profesionale në të gjithë Shqipërinë, në përputhje me nevojat e tregut.	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 . Plani i Optimizimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional, miratuar në Qershor 2022.	Jo
6	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 161, datë 21.03.2018, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Ndryshimet e kërkuara vijnë në kuadër të ndryshimeve dhe iniciativës së Qeverisë për shërbimet <i>online</i> , të Reformës së derregullimit dhe vënies në funksion të Sistemit të Shërbimeve të Punësimit.	Përshtatjen me ndryshimet e ndodhura që nga miratimi i VKM-së nr. 161, datë 21.03.2018, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, në 2018.	Jo	Po, Kapitulli 2 “Shoqëria digjitale”	Po, Strategjia për Punësimin dhe Aftësim 2019-2022, Punësim i denjë.	Jo
7	Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe të ligjit vjetor të buxhetit.	Shpërndarja e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2022	Jo	Jo	Jo	Jo
8	Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike 2023.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Paraqet një kalendar me aktivitetet dhe datat përkatëse për një mire menaxhim të financave publike	Jo	Jo	Jo	Jo
9	Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Përcaktimi i tavaneve paraprake të shpenzimeve për periudhën afatmesme për çdo institucion buxhetor	Jo	Jo	Jo	Jo
10	Për përcaktimin e rregullave e të kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit në parqet teknologjike dhe shkencore.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.	Rregullimin e procedurave për përzgjedhjen e zhvilluesit në Parqet Teknologjike dhe Shkencore dhe lidhja e kontratës ndërmjet zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës	Jo	Jo	Jo	Rritjen e investimeve të huaja dhe punësimi
11	Për miratimin e rregullores	Projektvendim	Ministri i	Katërmujori	Në zbatim të nenit 18, të	Përcaktimin e rregullave të funksionimit	Jo	Jo	Jo	Rritjen e investimeve të huaja dhe



	së funksionimit të parqeve teknologjike dhe shkencore.		Financave dhe Ekonomisë	i parë	ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.	të parqeve dhe mënyrën e përzgjedhjes së përdoruesit.				punësim
12	Për procedurat dhe kriteret për përfitim të lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe operatorët që operojnë në parqet teknologjike dhe shkencore.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Në zbatim të nenit 18, të Ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.	Mënyrën e përfitimit të lehtësirave fiskale	Jo	Jo	Jo	Rritjen e investimeve të huaja dhe punësim
13	Për miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2022.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i parë	Projektakti i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.	Dokument informues, i cili paraqet në mënyrë të detajuar ndihmën shtetërore	Po, PKIE 23-25, Kapitulli 8 Politikat e Konkurrencës	Jo	Jo	Jo
14	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Përafërsisht plotësisht me Rregulloren (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me tregimin e produkteve dhe shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 339/93”, Numri CELEX: 32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. L 218, datë 13.8.2008, faqe 30-47.	Shtimi i fushave të akreditimit/Parashikim i afateve në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative/Përdorimi i të ardhurave për zhvillimin e akreditimit	Po PKIE 2023- 2025, kapitulli 1 Lëvizja e Lirë e mallrave	Jo	Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut	Po (ritje e aplikimeve për akreditim sipas fushave të reja)
15	Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2022.	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Qëllimi i projektligjit është miratimi i buxhetit faktik të Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2022. Hartimi i këtij projektligji lidhet me plotësimin e kërkesës ligjore: nenit 62 dhe 63 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Nëpërmjet këtij projektligji sigurohet publikimi i informacionit të plotë mbi performancën makrofiskale dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2022, objektivat e arritura nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme.	Jo	Jo	Strategjia, “Për menaxhimin e financave Publike”: Objekti 5 “Transparenca e Financave Publike”, Komponenti: “Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës”.	Jo
16	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për vendosjen e masave administrative nga autoritetet doganore në zbatim të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Në pikën 5, të nenit 17/1 të ligjit nr. 33/2019 është parashikuar që Këshilli i Ministrave të nxjerrë rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të këtij neni. Projektvendimi synon të trajtojë paqartësitë/çështjet që kanë dalë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me zbatimin e nenit 17/1, duke	Projektvendimi synon: - rritjen e kontrollit të lëvizjes së parasë Cash/metaleve dhe gurëve të çmuar si dhe çdo instrumenti monetar objekt i deklarimit në PKK. - zvogëlimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit dhe rritjen e kontrollit me vendosjen për herë të parë të gjobave për mosdeklarim vlerash në	Jo	Jo	Jo	Po prodhon efekte financiare.



					përcaktuar rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të këtij neni, në veçanti procedurat për vendosjen e masave administrative nga autoritetet doganore. Projektvendimi synon përbushjen e një pjese të rekomandimeve dhe/ose kritereve të dala nga vlerësimi i Raundit të 5-të, të kryer nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës.	PKK - koordinimin me organet e tjera ligjzbatuese në rastet e mosdeklarimit të vlerave monetare në PKK. - zbulimin dhe goditjen e kërcënimeve për pastrimin e parave/ financimin e terrorizmit, si dhe dënimi zhveshja e autorëve nga përfitimet e paligjshme.				
17	Për përcaktimin e koeficienteve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Për zbatimin e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.	Koeficientet e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve	Po, PKIE 23-25, Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi”	Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë.	Jo	Po, Sociale
18	Për indeksimin e pensioneve.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Për indeksimin e pensioneve.	Mbajtja në nivele optimale vlerën reale të pensioneve dhe përfitimeve të tjera sociale	Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi”	Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë	Jo	Po, Sociale
19	Për procedurat e aplikimit për strehim të qytetareve dhe miratimit të tyre nga bashkitë; procedurat e aplikimit të bashkive për fonde pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin dhe baza e të dhënave që sigurohen dhe menaxhohen nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Në zbatim të politikës qeveritare për digitalizimin e sistemeve; Zbatimi i ligjit, pas miratimit të ndryshimeve ligjore, nenet 14/72/73.	Përcaktimin dhe shtimi i procedurave të paraqitjes së kërkesës për strehim online, procedurat e miratimit dhe përpunimit të të dhënave që gjenerohen nga sistemi i aplikimeve, si edhe përcaktimin e procedurave të paraqitjes së kërkesave për financim nga bashkitë, nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania.	Jo	Kapitulli 7 “Strehimi” i Programit Politik të Qeverisë 2021-2025	Jo	Efekte ekonomike - Po, Efekte sociale Po, Efekte mjedisore Po
20	Për miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Projekt dokument informues, i cili paraqet në mënyrë të detajuar kotimin e politikave publike dhe reformave strukturore deri në nivel produkti, të shoqëruar në çdo rast me KPI në nivel qëllimi dhe objektiv, për të gjitha ministrinë e linjës dhe Institucionet e tjera buxhetore, në zbatim dhe përputhje plotë me tavanet buxhetore përgatitore të miratuara.	Jo	Jo	Jo	Jo
21	Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Përcaktimi i tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për periudhën afatmesme për çdo institucion buxhetor	Jo	Jo	Jo	Jo
22	Për kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës me qira, enfitozë, leasing, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i dytë	Në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, përcaktimin e kritereve dhe procedurave	Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kriteret dhe procedurat që zbaton Korporata e Investimeve Shqiptare (në vijim Korporata) për: a) dhënien e pronës me qira, enfitozë, leasing apo	Jo	Jo	Jo	Jo



	ose të përdonimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare.				për dhënie e pronës, me qira, enfitozoë, leasing, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral, ose të përdorimit në forma të tjera nga ana e korporatës së investimeve shqiptare.	përmes formash të tjera përdorimi; b) shfrytëzimin e pronës për sigurimin e një kredie apo detyrimi tjetër; dhe c) shitjen dhe transferimin e pronës.				
23	Për markat tregtare dhe të shërbimit.	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Ndaja e legjislacionit në fushën e Pronësisë Industriale për çdo objekt të PI, për shkak të natyrës së veçantë që ka çdo objekt, si dhe përafrimi me direktivat e BE-së. Gjithashtu, hartimi i ligjit të ri është sipas modeleve më të mira të BE-së, ku për çdo objekt të PI ka ligj të veçantë.	Përafrimi me direktivat dhe rregulloret e BE; 1. Direktive (EU) nr. 2015/2436 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 16 Dhjetor 2015 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare. 2. Rregullore (EU) 2017/1001 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 14 qershor 2017, për markat tregtare të Bashkimit Evropian. Gjithashtu dhe saktësimi i disa procedurave për të cilat ka pasur mangësi si p.sh.; rregullimi i procedurave për njoftimin e pronarit të markave ndërkombëtare në rastet e depozitimit të një kërkesë për shfuqizim/zhvlerësim, rregullimi ligjor i masave të përkohshme në rastin e një padie për shkelje të të drejtave në gjykatë etj.	Kapitulli 7 “Pronësia intelektuale”	Jo	Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022-2025	Po
24	Për patentat për shpikje dhe modelet e përdorimit.	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Ndaja e legjislacionit në fushën e Pronësisë Industriale për çdo objekt të PI, për shkak të natyrës së veçantë që ka çdo objekt, si dhe përafrimi me direktivat e BE-së. Gjithashtu hartimi I ligjit të ri është sipas modeleve më të mira të BE-së, ku për çdo objekt të PI-së ka ligj të veçantë.	Përafrimi me direktivat dhe rregulloret e BE; 1. Rregullore 2019/933 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropës, e 20 majit 2019, që amendon. Rregulloren nr. 469/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 6 Maj 2009 për certifikatat e mbrojtjes shitesë për produktet mjekësore. Gjithashtu dhe saktësimi i disa procedurave për të cilat ka pasur mangësi si p.sh.; rregullimi i procedurave për transferimin e pronësisë së patentës për shpikje kur shoqëria-pronare e patentës është bashkuar/përthithur me një tjetër shoqëri; rregullimi ligjor i masave të përkohshme në rastin e një padie për shkelje të të drejtave në gjykatë etj.	Kapitulli 7 “Pronësia intelektuale”	Jo	Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022-2025	Po
25	Për buxhetin e vitit 2024	Projektligj	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Projektakti i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Përcaktimi i të ardhurave dhe Shpenzimeve të Buxhetit të shtetit, duke synuar në mirënjohjen progresive të të ardhurave, dhe eficientë, në mënyrat e përdorimit të fondeve publike në sektorët prioritarë dhe jo vetëm, duke mbajtur në konsideratë nga ana tjetër uljen e Deficitit Buxhetor dhe të Borshit Publik.	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Për ndryshimin e ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet	Projektligj	Ministri i Financave dhe	Katërmujori i tretë	Nevoja për të përshtatur me direktivat e BE në kuadër të	Përshtatja e legjislacionit në fushën e koncesioneve/PPP me Acqui	Po është parashikuar në kapitullin e 5 "Prokurimi Publik"	Jo	Jo	Po



	dhe Partneritetin publik privat”.		Ekonomisë		procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, nevoja për rishikimin e këtij ligji në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së tij dhe reflektimi i sugjerimeve të FMN dhe Bankës Botërore.	Communautaire				
27	“Për pranimin e Protokollit për ndryshimin e Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë; Marrëveshjen për Subvencionet e Peshkimit”.	Projektligji	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Projektligji, “Për pranimin e Protokollit për ndryshimin e Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë, Marrëveshja për Subvencionet e Peshkimit”, ka për qëllim miratimin e protokollit amendues për të përfshirë Marrëveshjen për Subvencionet e Peshkimit në Aneksin 1A të Marrëveshjes së OBT-së.	Protokolli përmban nene që lidhen me përkufizimet dhe qëllimin e marrëveshjes, subvencionet që kontribuojnë në peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar, subvencionet që lidhen me rezervat e mbipeshkimit dhe subvencione të tjera, asistencën teknike për vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara, njoftimin dhe transparencën, angazhimet institucionale, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe dispozitat përfundimtare.	Jo	Jo	Jo	Po . Në mbështetje të kësaj ndihme, do të krijohet një mekanizëm financimi vullnetar i OBT-së në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare përkatëse, si Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) dhe Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë. Kontributet e Anëtarëve të OBT-së për mekanizmin do të jenë ekskluzivisht në bazë vullnetare dhe nuk do të përdorin burime të rregullta buxhetore. - Një tjetër përfitim nga kjo marrëveshje është se me hyrjen në fuqi të saj, vendet e zhvilluara që janë edhe ato të cilat zbatojnë më shumë politika subvencionuese, nuk do të mundin të subvencionojnë flotat e tyre të peshkimit për të rritur sforcën dhe mbipeshkuar resurset peshkore gjë që ka ndikim në rritjen e stoqeve të peshkut / rezervave natyrore të burimeve peshkore në nivel global në përgjithësi dhe në pëllgun e Mesdheut në veçanti.
28	Për sigurimin e detyrueshëm në banesa.	Projektligji	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Ky ligj rregullon sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmeti në RSH.	Ky ligj rregullon sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmeti në RSH.	Jo	Jo	Jo	Po
29	Për investimet	Projektligji	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Projektligji, “Për investimet” synon : (1) të përditësojë legjislacionin ekzistues të investimeve me standardet më të mira ndërkombëtare; (2) të vendosë një skemë të re ligjore të unifikuar dhe konkurruese për të tërhequr investimet e reja vendase dhe të huaja, po ashtu (3) të garantojë përputhshmërinë me legjislacionin e brendshëm dhe me	Projektligji, “Për investimet” synon : (1) të përditësojë legjislacionin ekzistues të investimeve me standardet më të mira ndërkombëtare; (2) të vendosë një skemë të re ligjore të unifikuar dhe konkurruese për të tërhequr investimet e reja vendase dhe të huaja, po ashtu (3) të garantojë përputhshmërinë me legjislacionin e brendshëm dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Ky projektligj zëvendëson ligjet ekzistuese e konkretisht ligjin nr. 7764, datë 2. 11. 1993, “Për investimet e huaja” dhe ligjin	Jo	Jo	Jo	Po



					marrëveshjet ndërkombëtare. Ky projektligj zëvendëson ligjet ekzistuese e konkretisht ligjin nr. 7764, datë 2. 11. 1993, “Për investimet e huaja” dhe ligjin nr. 55/ 2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, por sjell po ashtu për herë të para barazi dhe mbrojtje të njëjtë si për investimet vendase dhe të huaja, si dhe krijon një mekanizëm më efikas të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në këtë fushë.	nr. 55/ 2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, por sjell po ashtu për herë të para barazi dhe mbrojtje të njëjtë si për investimet vendase dhe të huaja, si dhe krijon një mekanizëm më efikas të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në këtë fushë. Përmirësimi i legjislacionit në fushën e investimeve sjell një klimë më të favorshme si për investimet vendase dhe të huaja, duke dhënë një efekt pozitiv në ekonominë e vendit me përfitime konkrete si: rrjedhjen e kapitalit shtesë, krijimin e vendeve të reja të punës, duke përfshirë punë të lartë e të kualifikuar, transferimin teknik dhe menaxherial të dijeve, përmirësimin e aksesit në zinxhirin e vlerave ndërkombëtare dhe rrjetet e shpërndarjes së ndërmarrjeve shumëkombëshe etj. Miratimi i projektligjit, “Për investimet” ka lindur si domosdoshmëri, pasi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë i jepte një mbrojtje shtesë investimeve të huaja, por jo atyre vendase, ndërkohë që një korpus i ri ligjor më vete ishte krijuar për investimet strategjike. Në këto kushte u mendua që hartimi i një ligji të unifikuar të investimeve që mbron njësoj si investimet vendase, por dhe ato të huaja, duke u përshkruar i gjithë ligji nga parimet e transparencës, barazisë dhe të trajtimit pa diskriminim të investitorëve do të rriste garancinë e investitorëve. Risi në projektligj përbën trajtimi i një mekanizmi të shpejtë brenda pushtetit ekzekutiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i lindin një investitori me institucionet shtetërore, duke u përpjekur kështu të evitohen kostot e shtuara gjyqësore apo të tjera. Me anë tjetër, miratimi i projektligjit, “Për investimet” përveçse ndikon drejtpërdrejtë në krijimin e një klime më të favorshme për investimet në vend e duke sjellë kështu efekte pozitive në ekonomi, pritet të sjellë garanci e standarde të përparura në disa fusha. Po ashtu ligji siguron zbatimin e standardeve dhe rregulloreve të punës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.				
30	Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujor i tretë	Përditësimi i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, sipas versionit të Bashkimit	Zbatimin e saktë të niveleve të tarifës doganore, Marrëveshjes së Stabilitizimit Asocimimi dhe Marrëveshjeve të	Po, Kapitulli 29. Projektvendim, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së	Po. Në rubrikën “Integrimi evropian “ përcaktohet që Programi qeverisës për integrimin	Jo	Po prodhon efekte financiare dhe ekonomike.



	Kombinuar të mallrave 2023.				Evropian. Në datë 1 janar 2023, Administrata Doganore Shqiptare duhet të zbatojë të njëjtën Nomenklaturë Mallrash si Bashkimi Evropian. Në bazë të kësaj Nomenklature zbatohen nivelet kombëtare të tarifës doganore, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Marrëveshja Interim si dhe Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë.	Tregëtisë së Lirë; Shkëmbimin e informacionit me autoritetet doganore evropiane si dhe lehtësimin e raportimeve statistikore dhe procedurave doganore për shkëmbimet tregtare me vendet e BE.	Kombinuar të mallrave 2023”	europian 2021-2025 synon që Shqipëria të ecë edhe më shpejt, me qëllim që qytetarët të shohin një datë të qartë se kur i gjithë ky proces mund të finalizohet me Shqipërinë si një vend anëtar të Bashkimit Evropian.		
31	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Ekzekutimi i borxhit doganor është një problematikë e hasur ndër vite. Kodi Doganor ashtu sikurse një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore parashikojnë detyrimin për bashkëpunim ndërmjet institucioneve me qëllim zbatimin e detyrave të tyre funksionale e për rrjedhojë përmbushjen e detyrimeve ligjore. Miratimi nga Këshilli i Ministrave i dispozitave rregulluese për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve, ku përcaktohen detyra e përgjegjësi nga institucione të ndryshme do të sjellë efektivitet në rikuperimin e borxhit doganor, duke ndikuar jo vetëm në zbatimin e ligjit por edhe në të ardhurat e buxhetit të shtetit.	Projektvendimi synon të rregullojë modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera publike ose private, me qëllim vjeljen e borxhit doganor, përmes trajtimit të disa dispozitave në zbatim të nenit 10, shkronjës “b” të nenit 100 dhe pikës 3, të nenit 280, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	Jo	Jo	Jo	Projektvendimi pritet të ketë efekte pozitive për rritjen e të ardhurave në buxhet. Miratimi nga Këshilli i Ministrave i dispozitave rregulluese për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve, ku përcaktohen detyra e përgjegjësi nga institucione të ndryshme do të sjellë efektivitet në rikuperimin e borxhit doganor, duke ndikuar jo vetëm në zbatimin e ligjit por edhe në të ardhurat e buxhetit të shtetit.
32	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit, 2023.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Shpërblimi i pensionistëve për festat e fundvitit, 2023.	Masa e shpërbimit të pensionistëve	Jo	Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë	Jo	Po, Sociale
33	Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026, të rishikuar.	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Projektakti i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Dokument informues, i cili paraqet në mënyrë të detajuar kotimin e politikave publike dhe reformave strukturore deri në nivel produkti, të shoqëruar në çdo rast me KPI në nivel qëllimi dhe objektiv, për të gjitha ministratë e linjës dhe Institucionet e tjera buxhetore, në zbatim dhe përputhje plotë me tavanet buxhetore përfundimtare të miratuara.	Jo	Jo	Jo	Jo
34	Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e gazit dhe përcaktimin e listës së standardeve të	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori i tretë	Projektakti del në zbatim të nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e	Projektvendimi përcakton kushtet për vendosjen në treg të pajisjeve të gazit, duke garantuar sigurinë për konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë, si	Po. Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”	Jo	Jo	Jo



	harmonizuar”.				tregut të produkteve jo ushqimore”, për plotësimin e bazës ligjore në përputhje me legjislacionin e BE për të garantuar sigurinë e produkteve në treg dhe lëvizjen e lirë të pajisjeve të gazit, nëpërmjet përcaktimit të tërësisë së rregullave për tregtimin e këtyre pajisjeve.	dhe eliminimin e pengesave tregtare për lëvizjen e lirë të produkteve. Përcakton gjithashtu kërkesat për tregtimin e këtyre pajisjeve, detyrimet e operatorëve ekonomikë, si dhe masat që duhen ndërmarrë lidhur me pajisjet që paraqesin rrezik për sigurinë apo shëndetin etj.			
--	---------------	--	--	--	--	--	--	--	--

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2023
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
135.	SAFARI Parastou سفری پرستو	DOB: 1986 POB: Kermanshah, Iran Nationality: Iranian Gender: female Function: Member of the squad that arrested Mahsa Amini	Parastou Safari is a member of the Morality Police (EU-listed), an Islamic religious police that is part of Iran's Law Enforcement Forces (LEF). She is one of the officers in the squad that arrested Mahsa Amini. On 13 September 2022, Safari and three other members of a squad arbitrarily arrested 22-year old Mahsa Amini in Tehran, allegedly for wearing a hijab improperly. She was subsequently taken to the Morality Police's headquarters for an "educational and orientation class". According to reliable reports and witnesses, she was brutally beaten and mistreated in custody, which led to her hospitalisation and death on 16 September 2022. The Morality Police's abusive behaviour is not confined to this incident and has been widely documented. As one of the officers who arrested Amini, Parastou Safari is responsible for Amini's death and is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	14.11.2022



14.11.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 293 I/59

Entities

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
'9.	The Basij Cooperative Foundation (a. k.a. Bonyad-eh Ta'avon-e-h Basij) بنیاد تعاون بسیج	Address: Tehran, Iran Type of entity: Foundation/Corporation Network Other associated entities: IRGC, Basij Resistance Force	The Basij Cooperative Foundation (BCF) is one of the affiliates of the Basij Resistance Force (EU-listed). The BCF was established in 1996 and its mission includes promoting and supporting the Basij. The activities of the BCF include the funding of the Basij Resistance Force (EU-listed). Therefore, the BCF is associated with the Basij Resistance Force, an entity responsible for serious human rights violations in Iran.	14.11.2022
10.	Press TV پرس تی وی	Address: 4 East 2nd St., Farhang Blvd., Saadat Abad, 19977-66411 Tehran, Iran Telephone number: Tel. +98 21 230 66 660 Email: Pressstv@presstv.ir Type of entity: State Television Broadcaster	Press TV is responsible for producing and broadcasting the forced confessions of detainees, including journalists, political activists, persons belonging to Kurdish and Arab minorities, violating internationally recognised rights to a fair trial and due process. Therefore, Press TV is responsible for serious human rights violations in Iran.	14.11.2022



	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
11.	Arvan Cloud (a.k.a. Abr Arvani; Noyan Abr Arvan Co.; Arvan Company; Arvancoud) آر وون كلود	Address: Zafar St. Africa Blvd., Tehran, Iran Type of entity: Private Company Other associated entities: IRGC, Iranian Ministry of Information and Communications Technology	Arvan Cloud is an Iranian IT company supporting the Iranian government's efforts to control access to the Iranian intranet. Since 2020, it is a major partner in the project of the Iranian government, in general, and the Iranian Minister of Information and Communications Technology, in particular, to set up a separate, Iranian version of the internet. Such a national intranet with connecting points to the global internet will help to control the flow of information between the Iranian intranet and the global internet. As such, Arvan Cloud is involved in censorship and efforts of the Iranian government to shut down the internet in response to recent protests in Iran. Arvan Cloud is also associated with persons responsible for serious human rights violations in Iran, notably the EU-listed Iranian Minister of Information and Communications Technology.	14.11.2022



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.240, datë 16.12.2022

PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË
INVESTIMIT PËR PAJISJEN ME LEJE
UNIKE PËR INVESTITOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6, të nenit 69, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”,

UDHËZOJMË:

1. Vlera e investimit për aktivitetin ekonomik, për të huajin që pajiset me leje unike si investitor, të jetë jo më pak se 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohet Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 242, datë 20.12.2022

MBI BASHKËPUNIMIN E
STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME,
MINISTRISË SË BRENDSHME DHE
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
PËR PROCEDURAT E LËSHIMIT TË
VIZAVE PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 22, pika 5, nenit 24, pika 2, nenit 25, pika 6, nenit 28, pika 2, nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858/2021, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”,

me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për lëshimin e vizave, hyrjen, qëndrimin dhe tranzitimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

I. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË
PROCEDURËN E LËSHIMIT TË VIZAVE
PULLË DHE ELEKTRONIKE

1. Autoritetet përgjegjëse, që bashkëpunojnë në procesin e lëshimit të vizave pullë dhe elektronike për hyrjen, qëndrimin dhe kalimin tranzit të të huajve në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më poshtë MEPJ) – Drejtoria e Çështjeve Konsullore (më poshtë “DÇK”) dhe Përfaqësia Diplomatike dhe Konsullore (më poshtë “PDK”) të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit;

b) në Ministrinë e Brendshme (më poshtë “MB”) – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit (më poshtë “DKM”);

c) shërbimi Informativ i Shtetit (më poshtë “SHISH”).

2. Brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, secili nga autoritetet e sipërpërmendura bashkëveprojnë për çështjet e trajtimit të aplikimeve për viza, për hyrjen, qëndrimin dhe kalimin tranzit të të huajve, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

II. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR VIZË
NË PDK

1. Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore të RSH-së pranojnë kërkesat për pajisje me vizë të shtetasve të atij vendi apo rezidentë në atë vend, sipas listës në aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858/2021, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, apo të përfaqësuesve të shoqërive turistike shqiptare ose të shtetasve të tjerë të huaj, sipas miratimit paraprak të DÇK-së në MEPJ.

2. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesës për vizë pullë ose elektronike, të paraqitur *online* nga i huaji në PDK, kryhet nga nëpunësi konsullor i autorizuar dhe i trajnuar për çështjet e vizave, si dhe i certifikuar për shqyrtimin e dokumentacionit të klasifikuar, i cili në rast dyshimi interviston të



huajin për verifikimin e fakteve të paraqitura në kërkesë (më poshtë “Konsulli”).

3. Aplikimi për vizë pullë ose elektronike pranohet kur dokumentacioni i ngarkuar *online* është, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, të ndryshuar. Konsulli kalon në parregullsi statusin e aplikimit kur konstaton se dokumentacioni nuk është i plotë, ose kur kërkon dokumentacion shtesë nëse e ka gjykuar të arsyeshme. Arsyeja e parregullsisë i komunikohet të huajt elektronikisht.

4. Në raste kur i huaji aplikon për leje unike, aplikimi për vizë pullë ose elektronike bëhet *online* sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 858/2021, të ndryshuar, duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm dhe mandat pagesën e tarifës së vizës, e cila është e pakthyeshme.

5. Pas pranimi të aplikimeve për vizë pullë ose elektronike dhe pagesës së tarifës së vizës, konsulli brenda ditës, procedon aplikimet pranë DÇK. Në momentin e përcjelljes për vlerësim, Konsulli verifikon përsëri të dhënat në aplikim, duke vendosur prioritetin e trajtimit të aplikimit (normal, i lartë, shumë i lartë) dhe në rubrikën shënime vendos vlerësimin mbi dokumentacionin dhe mendimin (pozitiv, negativ apo i dyshuar). Ai mban përgjegjësi për saktësinë e përcjelljes së të dhënave.

6. Aplikimi për vizë elektronike përfundon me marrjen e përgjigjes së aplikimit dhe gjenerimin e përcjelljen elektronikisht të vizës, në rast aprovimi. Ndërsa aplikimi për vizë pullë, në rast aprovimi nga sistemi *e-Visa*, përfundon me përcjelljen e përgjigjes mbi aplikimin dhe caktimin e datës dhe orës së paraqitjes në Misionin Diplomatik ose Postin Konsullor për tërheqjen e vizës. Afati për marrjen e përgjigjes është 15 ditë pune nga data e pranimi të aplikimit, nëse nuk ka afate të tjera të parashikuara në marrëveshje ndërkombëtare. Në raste të shtyrjes së këtij afati, por gjithmonë pa kaluar afatet e përcaktuara në nenin 24, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, për shkak të zgjatjes së procedurës së vlerësimit të aplikimit, PDK-ja është e detyruar të njoftojë aplikuesin së paku 1 ditë para.

7. Në rast se gjatë procedurës së pranimi të aplikimit konstatohet paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, Konsulli refuzon dhënien e vizës, duke specifikuar në aplikim “REFUZUAR”, shënon datën e refuzimit, sekuestron dokumentin e falsifikuar, si dhe informon MEPJ-në për rastin e konstatuar dhe vepron sipas udhëzimeve që i jepen.

8. Në rastet e aplikimit për pajisje me leje unike, për kategoritë e të huajve, të cilët në bazë të ligjit duhet të marrin miratimin e punësimit, aplikimi i vizës shqyrtohet pasi të jetë aprovuar miratimi i punësimit nga autoriteti përgjegjës për çështjet e punësimit.

9. Në rastet e aplikimit për vizë të tipit D, e cila do të pasohet me aplikim për leje qëndrimi ose leje unike në Shqipëri, Konsulli mund të informojë të huajin mbi dokumentacionin e nevojshëm që të huajt do t'i nevojitet në Shqipëri nga vendi i origjinës.

10. Pas miratimit të vizës për rastet e aplikimit për leje unike, aplikimi do të kalojë për shqyrtim dhe vlerësim pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin.

III. PROCEDURA E TRANSFERIMIT TË APLIKIMIT NË NJË PDK TJETËR

1. Për interesa shtetërorë, raste humanitare ose rrethana të tjera të justifikuara, aplikimet për vizë pullë dhe elektronike mund të pranohen në një PDK të ndryshme nga lista e miratuar në aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, të ndryshuar. Transferimi i aplikimit bëhet pas miratimit nga DÇK-ja në MEPJ, për rastet, si më poshtë:

a) bazuar në kërkesën e aplikantit apo pritësit të tij, sipas formularit në aneksin nr. 1 dhe dokumentacionit mbështetës;

b) bazuar në kërkesën e paraqitur nëpërmjet postës zyrtare elektronike të DÇK-së;

c) në rastet kur DÇK transferon rastet për arsye objektive të ndonjëres Përfaqësi, pa pasur kërkesë nga vetë aplikantët.

2. Brenda 3 ditëve pune, DÇK-ja shqyrton kërkesën për transferimin e aplikimit të të huajt së bashku me dokumentacionin mbështetës, merr vendim dhe njofton me shkrim kërkuuesin për miratimin ose refuzimin e transferimit të aplikimit në një PDK tjetër. Për miratimin njoftohet PDK-ja respektive që do të shqyrtojë aplikimin.

3. Në rast refuzimi, brenda 5 ditëve pune pas marrjes së njoftimit, të interesuarit kanë të drejtën e apelit, duke paraqitur dokumentacion ose argumente shtesë. Kërkesa apeluere i drejtohet sërish DÇK-së, bashkë me dokumentacionin shtesë në favor të transferimit. DÇK-ja merr vendim dhe brenda 2 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për apelim, jep sërish përgjigje me shkrim. Korrespondenca mund të mbahet dhe



përmes postës elektronike. Me shqyrtimin e kërkesës apeluese, mbyllet procesi i shqyrtimit të transferimit.

IV. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE PËR VIZË

1. Nëpunësi i autorizuar për shqyrtimin e vizave në DÇK (më poshtë “nëpunësi shqyrtues”) kryen veprimet paraprake verifikuese për rregullshmërinë e aplikimeve të dërguara nga PDK-ja dhe përcjell brenda ditës aplikimet për vlerësim në drejtim të DKM-së dhe SHISH-it në sistemin *e-Viza*.

2. DKM-ja shqyrton dhe verifikon kërkesat për vizë ardhur nga MEPJ, duke konsultuar bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit, profilet e hartuara nga analiza e riskut për vendet e origjinës dhe të dhënat e ftesit në Shqipëri.

3. Brenda 5 ditëve pune, DKM-ja dhe SHISH-i japin mendimet e tyre në modulën *e-Viza*, nëse kërkesa duhet të miratohet ose refuzohet. DKM-ja dhe SHISH-i kanë të drejtë t'i kërkojnë DÇK-së zgjatje të afatit për vlerësim të aplikimit dhe për 5 ditë të tjera pune. Për raste të veçanta, kur është i domosdoshëm verifikimi i detajuar i të dhënave, afati i dhënies së mendimit nga DKM-ja dhe SHISH-i mund shtyhet së dyti dhe për 10 ditë pune të tjera pritjeje. Për nevojën për zgjatje njoftohet menjëherë PDK-ja dhe DÇK-ja, të paktën 1 ditë para kalimit të afateve të vendosura.

4. Të gjitha përgjigjet në modulën *e-Viza* për refuzim vize nga ana e DKM-së dhe SHISH-it, duhet të arsyetohen me argumentimin përkatës ligjor mbi arsyet e refuzimit. Përgjigjet e dhëna grupohen duke respektuar rregullat, si më poshtë:

a) rregullshmëria e dokumentit të paraqitur të udhëtimit;

b) justifikimi i qëllimit dhe kushteve të udhëtimit;

c) dëshmia se zotëron mjete të mjaftueshme jetese për kohëzgjatjen e qëndrimit ose për rikthimin në vendin e origjinës/vendbanimit ose për të kaluar tranzit në një vend të tretë;

d) respektimi i afateve në qëndrimet paraardhëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) dëshmia se zotëron siguracionet e përshtatshme mjekësore;

f) besueshmëria e duhur për motivin e kërkesës dhe të kushteve të qëndrimit;

g) garantimi i detyrimit për të lënë territorin e Republikës së Shqipërisë para përfundimit të vlefshmërisë së vizës;

h) refuzim mbështetur në të dhënat që posedojnë strukturat përgjegjëse, sipas nenit 28, të ligjit, “Për të huajt”. Në rastin kur arsyeja e refuzimit është informacion i klasifikuar, trajtohet sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, duke mos ekspozuar institucionin që ka dhënë arsyen e refuzimit;

i) arsye të tjera ligjore, të papërmendura më sipër.

5. Nëpunësi shqyrtues në DÇK, përcjell brenda ditës vendimin përfundimtar në PDK-në përkatëse. Për vizat e refuzuara jepet arsyeja e argumentuar. Aplikanti njoftohet nga PDK për refuzimin e vizës, si dhe për arsyen e këtij vendimi me formularin si në aneksin nr. 2.

6. Për rastet e kërkesave për vizë nga personalitetet e njohura shtetërore, si dhe personalitete të shquara në fusha të ndryshme, vizita e të cilëve në Shqipëri vlerësohet si interes kombëtar, me rekomandimin e kreut të misionit ku kryhet aplikimi, DÇK-ja mund të japë miratimin me procedurë urgjente, brenda 1 ditë pune, duke mos kryer konsultime të mëtejshme me strukturat e DKM-së dhe SHISH-it.

V. PROCEDURA E LËSHIMIT TË VIZËS PULLE DHE/OSE ELEKTRONIKE

1. Për aplikimet e miratuara nga DÇK-ja, nëpunësi konsullor në PDK verifikon të dhënat në vizën pullë ose elektronike sipas rubrikave:

E VLEFSHME PËR:

Shënohet hapësira ku do të jetë e vlefshme viza. Për territorin e RSH-së shënohet “Shqipëri/Albania”;

NGA:

Data e fillimit të vlefshmërisë së vizës, sipas kërkesës së aplikantit në format dd.mm.vvvv;

DERI:

Data e skadimit të vizës dhe njëkohësisht data e fundit e afatit të qëndrimit me vizë e të huajt në territorin e RSH-së;

AFATI I QËNDRIMIT:

Numri i përgjithshëm i ditëve të lejuara të qëndrimit përgjatë afatit të vlefshmërisë ose brenda 6 muaj nga hyrja e parë, “01” deri në “90” ditë;



NUMRI I HYRJEVE NË:

1, 2 ose M, respektivisht për një, dy ose shumë kalime;

Vendi i lëshimit (ku ndodhet PDK-ja);

MË:

Data e lëshimit në format dd.mm.vvvv;

NUMRI I PASAPORTËS:

Numri i pasaportës së të huajt;

EMËR/MBIEMËR

Emri dhe mbiemri i aplikantit, sipas mjetit identifikues të përdorur në aplikim

TIPI I VIZËS:

A për vizat aeroportuale tranzite, C për vizat afatshkurtër dhe D/XX për vizat e qëndrimit sipas motivit të lëshimit;

SHËNIME:

X1, X2, X3 numri i fëmijëve që shoqërojnë aplikantin dhe që janë të regjistruar në pasaportën e tij, tipi i vizës, kosto e vizës;

2. Për vizat tranzite aeroportuale të tipit A, mbahen parasysh rregullimet si më poshtë:

a) Vizat “një-hyrje” jepen me afat qëndrimi jo më shumë se 2 ditë dhe vlefshmëri jo më shumë se 7 ditë;

b) Vizat “dy-hyrje” jepen me afat qëndrimi jo më shumë se 3 ditë dhe vlefshmëri jo më shumë se 30 ditë;

c) Vizat “shumë-hyrje” jepen me afat qëndrimi deri në 15 ditë dhe vlefshmëri deri në 180 ditë.

3. Për vizat afatshkurtër të tipit C, mbahen parasysh rregullat, si më poshtë:

a) Afati i vlefshmërisë së vizës të tipit C jepet kurdoherë, në varësi të aktivitetit të aplikantit në territorin e RSH-së;

b) Vizat me “një-hyrje” dhe “dy-hyrje” jepen me afat qëndrimi sipas përcaktimeve në nenin 20, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, në varësi të kohëzgjatjes së aktiviteteve të aplikantit në Shqipëri, me vlefshmëri deri në 90 ditë.

c) Vizat “shumë-hyrje” të tipit C, jepen me afat qëndrimi sipas përcaktimeve në nenin 20, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me vlefshmëri 3, 6 muaj deri në 5 vjet.

4. Për të huajt që do të qëndrojnë në Shqipëri për një periudhë mbi 90 ditë brenda 180 ditëve, lëshohet viza e qëndrimit e tipit D, me vlefshmëri 1-vjeçare dhe kohë qëndrimi 90 ditë, por jo më shumë se 180 ditë, sipas përcaktimeve të nenit 21, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”. I huaji bëhet me dije për procedurat, dokumentacionin e

nevojshëm dhe afatet e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Pulla e vizës, pas printimit nga sistemi, pozicionohet në një faqe të lirë të pasaportës. Preferohet faqja përballë të jetë po ashtu e lirë. Pulla vendoset në mënyrë të tillë që fundi i saj të orientohet nga ana e jashtme e dokumentit. Pulla e vizës stampohet me vulën e PDK-së në mënyrë të atillë që gjurma e vulës të shkelë njëkohësisht mbi pullën vizë dhe faqen e pasaportës dhe në të njëjtën kohë të mos prekë asnjë nga shënimet brenda pullës apo zonën e leximit automatik të vizës.

6. Lëshimi/refuzimi i vizës, si dhe informacioni për vizën e lëshuar ruhen në sistemin *e-Viza*. Gjithashtu, informacioni i plotë për vizën e miratuar/refuzuar duhet të transferohet në sistemin TIMS (moduli hyrje/dalje) *online*. Pikat e Kalimit Kufitar (më poshtë “PKK”) duhet të kenë informacionin e plotë për vizën e lëshuar, para se i huaji të paraqitet për të hyrë në territor.

7. Në rastin e vizës elektronike, pas miratimit, kjo e fundi i përcillet aplikantit me anë të postës elektronike. Aplikanti e printon vizën nga cildo vend që ndodhet, me kushtin që të jetë jashtë territorit të RSH-së. Aplikuesi para hyrjes në territor duhet të paraqesë vizën elektronike të printuar nga *email-i*, si dhe dokumentin e identifikimit me të cilin ka aplikuar. Gjithashtu, vizën elektronike shtetasi i huaj duhet ta paraqesë edhe gjatë daljes nga territori i RSH-së në çdo PKK, me qëllim verifikimin e respektimit të afateve të vlefshmërisë së vizës.

8. Në rastin e vizës pullë, pas aprovimit, shtetasit duhet të paraqiten fizikisht në Misionin Diplomatik apo Postin Konsullor të RSH-së nga ku kanë kryer procedurën e aplikimit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në VKM nr. 858/2021, të ndryshuar.

VI. PROCEDURA E LËSHIMIT TË VIZËS NË KUFİ

1. Në rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, lëshimi i vizës në PKK bëhet me kërkesë të MEPJ, sipas procedurave në vijim:

a) kërkesa për pajisjen me vizë në kufi të shtetasve të huaj i drejtohet MEPJ-së nga institucionet shtetërore apo institucionet e tjera;

b) kërkesa duhet të përmbajë:



- të dhëna të mjaftueshme për aktivitetin dhe argumentimin e interesit shtetëror ose detyrimeve ndërkombëtare;

- argumentimin për pamundësinë për pajisjen me vizë në PDK jashtë vendit;

- përmbushjen e detyrimeve dhe garancive ligjore të marrjes përsipër të akomodimit të të huajve të ftuar, qëndrimit dhe largimit të tyre brenda afateve të vizës së kërkuar;

- informacion për mbërritjen e të huajit, qëndrimin dhe largimin nga Shqipëria;

- formularin e plotësuar për kërkesën për vizë në kufi, si në aneksin nr. 3;

c) pas vlerësimit të kërkesës, DÇK-ja i përcjell DKM-së, jo më vonë se 48 orë para lëshimit të vizës, kërkesën e miratuar për pajisjen me vizë në kufi të të huajit/ve, e cila duhet të përmbajë informacion mbi:

- gjeneralitetet e personit/ave që kërkohet të pajiset/en me vizë;

- dokumentin e udhëtimit;

- llojin e vizës;

- afatin e lëshimit dhe të përfundimit të vlefshmërisë së vizës;

- afatin e përdorimit;

- kushtin me/pa pagesë;

- PKK-ja ku do të lëshohet viza;

d) DÇK-ja i dërgon njëkohësisht konfirmimin mbi vizën në kufi palës së interesuar, për të lehtësuar qarkullimin e të huajve në kufijtë e shteteve të tjera;

e) DKM-ja përcjell menjëherë kërkesën për vizë në kufi në strukturat vendore të kufirit dhe migracionit, si dhe PKK-së ku i huaji do të paraqitet për marrjen e vizës dhe hyrjen në Shqipëri;

f) përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë sipas kërkesës së miratuar të MEPJ-së ardhur nëpërmjet DKM-së, duke kryer procedurat e zakonshme kufitare të verifikimit të hyrjes dhe të qëndrimit në RSH për shtetasit e huaj;

g) informacioni mbi vizën e dhënë regjistrohet në modulën përkatëse të *e-Vizës*.

h) autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin i dërgon SHISH-it në formë shkresore, informacion mbi vizën e dhënë deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Vizës* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi;

i) autoriteti i PKK-së ka të drejtën e refuzimit të hyrjes/vizës, nëse se i huaji nuk i plotëson kushtet e

hyrjes, kalimit tranzit dhe të qëndrimit në territorin e RSH-së. Për këtë njoftohet DÇK dhe DKM.

2. Në rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë tranzit të huajt, anëtarë të mjeteve të lundrimit, të cilët kërkojnë të imbarkohen apo riimbarkohen në një nga portet shqiptare, sipas procedurave në vijim:

a) i huaji, anëtar i mjetit të lundrimit dhe agjencia shqiptare portuale dorëzojnë pranë PKK në hyrje dokumentacionin në vijim:

- kërkesën për vizë tranzit, të dhëna të sakta mbi afatet e vizës, PKK-ja ku kërkon të imbarkohet apo riimbarkohet, mjetin ujqor në të cilin kërkon të imbarkohet apo riimbarkohet;

- pasaportën e të huajit anëtar i mjetit të lundrimit, kërkues i vizës dhe një fotokopje të faqes me gjeneralitetet e tij;

- konfirmimin nga Kapitenaria e Portit ku do të imbarkohet ose riimbarkohet kërkuesi i vizës për prezencën e mjetit të lundrimit me të cilin do të kryhet imbarkimi apo riimbarkimi;

- konfirmimin nga poseduesi i mjetit të lundrimit që do të imbarkojë apo riimbarkojë kërkuesin e vizës;

- certifikatën e mjetit të lundrimit me të cilin do të bëhet imbarkimi apo riimbarkimi i kërkuesit të vizës;

- deklaratën e garancisë së agjencisë shqiptare operuese, së bashku me dokumentacionin identifikues;

b) përgjegjësi i turnit verifikon dokumentacionin, vendos vizën pullë në dokumentin e udhëtimit, bën shënimet në regjistrin elektronik për të huajt (REH), njofton PKK-në përkatëse ku do të bëhet imbarkimi apo riimbarkimi i të huajit anëtar të ekuipazhit të lundrimit të pajisur me vizë dhe pasqyron informacionin mbi vizën e dhënë në komunikatën ditore;

c) PKK-ja në të cilën bëhet imbarkimi apo riimbarkimi, në momentin e imbarkimit apo riimbarkimit bën regjistrimin në dalje të anëtarit të mjetit të lundrimit dhe njofton PKK-në që ka lëshuar vizën për veprimet e kryera;

d) në rast mosnjoftimi të PKK-së lëshuese të vizës, brenda afatit të vlefshmërisë së vizës nga PKK-ja ku do të bëhet imbarkimi apo riimbarkimi, autoriteti i PKK-së lëshues i vizës njofton nëpërmjet autoritetit vendor të kufirit dhe



migracionit, autoritetin vendor të kufirit dhe migracionit në të cilin ndodhet PKK-ja ku do të bëhej imbarkimi apo riimbarkimi i anëtarit të mjetit të lundrimit, për të vijuar me procedurat e parashikuara ndaj shtetasit të huaj dhe agjencisë portuale, e cila ka bërë garancinë për shtetasin e huaj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”;

e) dokumentacioni përkatës për lëshimin e vizës ruhet në PKK për një afat 1-vjeçar. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, dërgon informacion mbi vizën e dhënë SHISH-it, deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Vizë* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi.

3. Në rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë tranzit, sipas procedurave të përshkruara në pikën 2, të kreut VI, të këtij udhëzimi, anëtarët e huaj të mjetit të lundrimit, që duhet të kthehen në vendin e origjinës pas përfundimit të kontratës apo në rastet e ndryshimit të ekuipazhit të mjeteve lundruese. Dokumentacioni që nevojitet në këtë rast është:

a) kërkesë për vizë tranzit, duke saktësuar afatin e vizës dhe PKK-të e daljes nga Shqipëria;

b) pasaportë e anëtarit të mjetit të lundrimit dhe një fotokopje të faqes me gjeneralitetet e tij;

c) rezervimi i biletës së udhëtimit;

d) deklaratë e garancisë së agjencisë shqiptare operuese së bashku me kopje të dokumentacionit të tij identifikues.

4. Autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin dërgon informacion mbi vizën e dhënë SHISH-it, deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Vizë* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi.

5. Përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë të huajin për rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2 shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, duke proceduar si vijon:

a) plotëson një raport shërbimi mbi situatën emergjente të krijuar dhe kur është e mundshme i bashkëngjit këtij raporti dokumente shpesh (informacione, shkresa zyrtare etj., nga institucione shtetërore ose jo, të përfshira në situata emergjente);

b) kërkon miratim me shkrim për lëshimin e vizës nga autoriteti vendor i kufirit dhe migracionit, pas konsultimit dhe aprovimit verbal nga DKM-ja;

c) pas miratimit nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, përgjegjësi i turnit vendos vizën

pullë në dokumentin e udhëtimit të të huajt, bën shënimet e nevojshme në REH, si dhe pasqyron informacionin në komunikatën ditore;

d) dokumentacioni përkatës për lëshimin e vizës ruhet në PKK për një afat 1-vjeçar;

e) autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin dërgon informacion mbi vizën e dhënë SHISH-it, deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Vizë* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi.

6. Përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë të huajin për rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, duke proceduar, si më poshtë:

a) kontrollon dokumentet spitalore ose të autoriteteve të tjera shtetërore përgjegjëse për lëshimin e tyre që vërtetojnë rastin e vdekjes ose të sëmundjes së rëndë, si dhe lidhjen me kërkuesin e vizës;

b) plotëson një raport shërbimi mbi rastin konkret;

c) kërkon miratim me shkrim për lëshimin e vizës nga autoriteti vendor i kufirit dhe migracionit, pas konsultimit dhe aprovimit verbal nga DKM-ja;

d) pas miratimit nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, përgjegjësi i turnit vendos vizën pullë në dokumentin e udhëtimit të të huajt, bën shënimet e nevojshme në REH, si dhe pasqyron informacionin në komunikatën ditore;

e) dokumentacioni përkatës për lëshimin e vizës ruhet në PKK për një afat 1-vjeçar.

f) Autoriteti Vendor për Kufirin dhe Migracionin dërgon informacion mbi vizën e dhënë SHISH-it, deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Vizë* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi.

VII. PROCEDURA E REFUZIMIT TË VIZËS

1. Për të gjitha rastet e refuzimit të vizave të parashikuara në nenin 28, pika 1, të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, vendimi i strukturave përcillet në DÇK, e cila ia komunikon nëpërmjet modulit (sistemit) *e-Vizë* PDK-së, së bashku me arsyen e refuzimit.

2. Konsulli njofton të huajin për refuzimin e vizës dhe i komunikon aktin administrativ, i cili gjenerohet në sistem dhe i shkon aplikuesit në postën elektronike, sipas formatit në aneksin nr. 2

3. Në asnjë rast Konsulli nuk duhet të japë informacion mbi institucionet apo autoritetin që ka dhënë mendim për refuzimin e vizës.



4. I huaji, pritësi ose institucioni ftues, kanë të drejtë që brenda 5 ditëve pune, të paraqesin kërkesën për apelim në DÇK. DÇK-ja, në koordinim me strukturat vlerësuese (ose vetëm “DKM”) brenda 5 ditëve pune, merr vendim dhe njofton të huajin, pritësin ose garantuesin.

VIII. PROCEDURA E ANULIMIT TË VIZËS

1. Për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 27, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, vendimi i anulimit të vizave merret nga PDK-ja ose DÇK-ja, kur viza është lëshuar nga këto autoritete dhe nga DKM-ja kur viza është lëshuar në kufi.

2. Me miratimin e DÇK-së konsulli në PDK vlerëson pavlefshmërinë e vizës, si dhe i komunikon të huajt nëpërmjet aktit administrativ, i cili gjenerohet nga sistemi dhe i dërgohet aplikuesit në postën elektronike. Njëkohësisht akti administrativ sipas formatit në aneksin nr. 2, së bashku me vendimin dhe arsyen e anulimit të vizës dërgohet në postën elektronike të Misionit Diplomatik apo Postit Konsullor, DÇK-së në adresën visa@mfa.gov.al dhe DKM-së në adresën policiakufitare@asp.gov.al. Anulimi i vizës duhet të evidentohet në sistemin *e-Visa* dhe TIMS, përpara se i huaji të hyjë në Shqipëri.

3. Kur i huaji ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, vendimi për anulimin e vizës i marrë nga PDK-ja ose DÇK-ja i përcillet DKM-së për zbatim. Informacioni për bërjen të pavlefshme të vizës pasqyrohet në sistemin *e-Visa* dhe TIMS.

4. DKM-ja, nëpërmjet procedurave të kontrollit të të huajve në territor, njofton të huajin për të cilin është marrë vendimi i anulimit të vizës, bën anulimin e vizës në pasaportën e të huajt sipas nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt” dhe informon MEPJ-në për zbatimin e kërkesës për anulimin e vizës.

5. Në rastet e anulimit të vizës sipas nenit 27, pika 1, shkronja “b” dhe “ç”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, DKM-ja anulon vizën e të huajt dhe merr masa për largimin e tij nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Në rast se autoritetet e përfshira në procedurën e lëshimit të vizës në DKM dhe SHISH konstatojnë një nga rastet për të cilat bëhet anulimi i vizës, i kërkojnë MEPJ-së anulimin e vizës për të cilën më parë kanë dhënë mendim pozitiv.

7. Në rast se kërkesa për anulimin e vizës bëhet

nga autoritetet doganore apo kufitare, sipas nenit 28, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, kërkesa drejtuar MEPJ-së për anulimin e vizës duhet të shoqërohet me argumente dhe prova që vërtetojnë shkeljet nga ana e të huajt.

8. I huaji ka të drejtë, brenda 3 ditëve pune nga momenti i marrjes së njoftimit, të apelojë pranë strukturës së DÇK-së, e cila merr në shqyrtim brenda 2 ditëve pune këtë kërkesë dhe njofton me shkrim të huajin për vendimin e marrë. Me dhënien e vendimit, procedura konsiderohet e mbyllur dhe bëhet njoftimi i strukturave të PDK-së dhe DKM-së. Korrespondenca mund të kryhet edhe përmes zyrës postare ose postës elektronike.

9. Pas njoftimit për anulimin e vizës i huaji nuk ka të drejtë të hyjë në territorin e RSH-së. Nëse gjendet në territorin e RSH-së, me përfundimin e procedurës së apelimit, i huaji duhet të largohet nga Shqipëria.

IX. ADMINISTRIMI I VIZAVE PULLË

1. DÇK-ja është autoriteti përgjegjës për menaxhimin dhe evidentimin e vizave pullë. DÇK-ja planifikon shpërndarjen e vizave pullë për PDK-në, sipas kërkesave të këtyre të fundit.

2. Në rast humbjeje, DÇK-ja njofton shtetet e huaja për seritë e pullave të humbura.

3. Në rast dëmtimi ose plotësimi të gabuar, konsulli në PDK evidenton numrin e vizës pullë me procesverbal, i cili arkivohet bashkërisht me vizën pullë të nxjerrë jashtë qarkullimit. Jo më pak se 2 herë në vit vizat pullë të nxjerra jashtë qarkullimit dërgohen në DÇK për asgjësim.

4. Asgjësimi i vizave pullë të nxjerra jashtë qarkullimit bëhet të paktën një herë në vit me komision të përbërë nga tri veta, specialisti përgjegjës për vizat në Drejtorinë e Çështjeve Konsullore, Përgjegjësi i Sektorit Konsullor dhe Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore. Në fund të asgjësimit mbahet procesverbal dhe të dhënat për vizat pullë të asgjësuarat i vihen në dispozicion DKM-së.

5. PDK-ja dhe PKK-ja regjistrojnë vizat pullë të marra dhe i administrojnë ato sipas kritereve të veçanta të administrimit të letrave me vlerë. PDK-ja dhe PKK-ja hedhin në përdorim vizat pullë sipas numrit rendor përkatës.



X. PROCEDURA E PËRLLOGARITJES SË AFATEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT QË HYJNË NË TERRITOR PA VIZË

1. Strukturat përgjegjëse të kufirit dhe migracionit gjatë kontrollit të të huajve në hyrje, qëndrimit dhe daljes së tyre nga Republika e Shqipërisë, përllogarisin afatet e qëndrimit dhe respektimin e kriterit të qëndrimit 90 ditë për 180 ditë, ose 1 vit për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo afatet e përcaktuara në një vizë ose leje qëndrimi, me të cilën i huaji kërkon të hyjë apo ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe afatet e parashikuara me marrëveshje qeveritare ose qëndrimin të njëanshëm, të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Në hyrje të RSH-së përllogaritja e afatit të qëndrimit në territor 90 ditë brenda 180 ditëve, bëhet referuar ditës së hyrjes duke numëruar mbrapa në kohë 180 ditë.

3. Nëse gjatë kontrollit në territor ose gjatë kontrollit në Pikën e Kalimit Kufitar, gjatë daljes së të huajt nga territori, konstatohet se i huaji ka qëndruar më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve të fundit, ose ka tejkaluar afatet e largimit të përcaktuar në një urdhër largimi/dëbimi, atëherë ai konsiderohet i huaj me qëndrim të parregullt në territor. Qëndrimi mbi afatin e sipërpërmendur mundësohet vetëm për të huajt që:

- a) janë të pajisur me leje qëndrimi/unike;
- b) posedojnë aktin e zgjatjes së afatit të qëndrimit;
- c) kanë marrëveshje qeveritare;
- d) kanë qëndrimin të njëanshëm, të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave;
- e) janë shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që qëndrojnë deri në 1 vit.

4. Dita e hyrjes dhe dita e daljes së të huajt llogariten secila nga një ditë qëndrimi. Nëse i huaji hyn dhe del brenda një dite, atëherë llogaritet 1 (një) ditë qëndrimi.

5. Për të huajt që hyjnë pa vizë, por për të aplikuar për leje qëndrimi/unike duhet të pajisen me vizë sipas motivit të kërkuar të qëndrimit, numërimi i ditëve të qëndrimit përllogaritet sipas hyrjes me vizë tipi “D” dhe afatit të përcaktuar në të.

6. Për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, llogaritja e afateve të qëndrimit bëhet mbi bazën e kriterit të qëndrimit të tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, 90 ditë, ose gjatë një viti qëndrimi, ose pas 1 (një) viti qëndrimi pa ndërprerje, ose së bashku si gjatë ashtu dhe pas qëndrimit 1 (një) vit. Afatet llogariten referuar ditës kur ndaj të huajt kryhet kontrolli duke numëruar mbrapa në kohë një vit.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

ZËVENDËSDREJTOR I SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT
Oljan Kanushi



Aneksi nr. 1

REQUEST FOR TRANSFERRING A VISA APPLICATION

(Kërkesë transferim të aplikimit për vize)

According to DCM 858/2021, Ch. II, A, Art. 6

(Bazuar në VKM 858/2021, Kreu II, A, pika 6)

I. Information on visa applicant (Të dhëna për aplikantin)

1. First Name:.....
2. (Emër)
3. Surname:.....
- (Mbiemër)
- Nationality:.....
- Adresa: (Shtetësia)
4. Date of Birth:..... / / (dd/mm/yyyy)
- Konsullore (Datëlindja dd/mm/yyyy)
5. Place of Birth:.....
- (Vendlindja)
6. Passport number:.....
- (Numri i pasaportës)
7. Passport expiry date:..... / / (dd/mm/yyyy)
- (Vlefshmëria e pasaportës)



Address/
REPUBLIC OF ALBANIA
Republika e Shqipërisë

MINISTRY FOR EUROPE
AND FOREIGN AFFAIRS
Ministria për Evropën dhe Punët e
Jashtme

Directorate for Consular Issues
Drejtoria për Çështjet

Bulevardi Gjergj Fishta 6
1000 Tirana;
Tel.: 00355-4- 23 64 090 ext. 79 157
Email: DK@mfa.gov.al

II. Information on person applying for the transfer (transfer applicant) (Të dhëna për personit që kërkon transferimin)

1. First Name:.....
- (Emër)
2. Surname:.....
- (Mbiemër)
3. Nationality:.....
- (Shtetësia)
4. Date of Birth:..... / / (dd/mm/yyyy)
- (Datëlindja dd/mm/yyyy)
5. Passport / ID number:.....
- (Numri i pasaportës ose ID)
6. Relation to visa applicant: ☐ Visa applicant: Guarantor of visa ☐ applicant:
- (Raporti me aplikantin për vizë) (Aplikanti për vizë)(Garantuesi i aplikantit për vizë)
7. Address of transfer applicant:.....
- (Adresa e aplikantit)
8. Telephone:
- (Telefon)
9. Mobile phone:.....
- (Telefon mobile)
10. E-mail:.....
- (Email)

III. Information on visa and purpose of request (Të dhëna për kërkesën për vizë dhe qëllimin e transferimit)

1. Emb./Consulate to apply at:.....
- (Përfaqësia ku kërkohet aplikimi)
2. Type of visa:..... ☐ Transit visa: C-Type ☐ visa: D-Type visa: ☐
- (Lloji i vizës) (Vizë transite)(Vizë tipi C)(Vizë tipi D)
3. Purpose of transfer request:.....
- (Motivet e kërkesës për transferim)

Signature of the transfer applicant:
(Nënshkrimi)

Place (Vendi)

Date (data)



Aneksi nr. 1

Remarks by the authorities / Only for official notes (Shënimet e autoritetit shqyrtues)			
Shqyrtuar:	___/___/___	Rishqyrtuar:	___/___/___
Shënim:		Shënim:	

Transfer Application Form V31
(Formular aplikimi për transferimin)



Aneksi nr. 2

STANDARD FORM NOTIFYING AND MOTIVATING REFUSAL/ANNULMENT
(Forma standard i njoftimit dhe motivimit të refuzimit/ anulimit)

REFUSAL/ANNULMENT OF VISA
(Refuzimi/Anulimi i vizës)



REPUBLIC OF ALBANIA
Republika e Shqipërisë

Ms./Mrs./Mr.: _____
(Z./Zgj./Zgjuh.)

☐ The Albanian Embassy/General Consulate/Other Competent Authority: _____
(Ambasada dhe Konsullata e Përgjithshme/Konsullatat/Autoritetet tjetër kompetente);

Has/have: (ka/kanë:)

☐ examined your visa application with the code number;
(shqyrtoar aplikimin tuaj për vizë me kod numër);

☐ examined your visa, number: _____ issued: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(shqyrtoar vizën me numër); (testuar më datë)

☐ The visa has been refused
(viza është refuzuar);

☐ The visa has been annulled;
(viza është anuluar);

This decision is based on the following reason(s):
(Ky vendim është i bazuar në arsye(n) e mëposhtme)

1. ☐ was presented a false/counterfeit document;
(është paraqitur një dokument i falsifikuar/i parregullt udhëtimi);
2. ☐ justification for the purpose and conditions of the intended stay was not provided;
(nuk justifikohet qëllimi i dhe kushtet e qëndrimit);
3. ☐ you have not provided proof of sufficient means of subsistence, for the duration of the intended stay or for the return to the country of origin or residence, or for the transit to a third country into which you are certain to be admitted;
(nuk dëshmohet se zotëroni mjete të mjaftueshme jetese për kohëgjatjen e qëndrimit ose për rikthimin në vendin e origjinës/shtetëzarisë ose për transituar në një vend të tretë, për të cilin nuk keni garancë se do të pranohet);
4. ☐ you have already stayed for three months during the current six-month period on the territory of Republic of Albania.
(kemi regjistruar që tani tre muaj për gjatësi muaj qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë);
5. ☐ proof of holding an adequate and valid travel medical insurance was not provided;
(nuk kemi dëshmuar se zotëroni sigurim mjekësor të përkatshëm dhe/ose të vlefshëm);
6. ☐ the information submitted regarding the justification for the purpose and conditions of the intended stay was not reliable;
(informacioni i paraqitur lidhur me motivin e kërkesës dhe të kushteve të qëndrimit të dënuar nuk është i besueshëm);
7. ☐ your intention to leave the territory of the Republic of Albania before the expiry of the visa could not be ascertained;
(nuk garantohej detyrimi juaj për të lënë territorin e Republikës së Shqipërisë para skadencës së vizës);
8. ☐ sufficient proof that you have not been in a position to apply for a visa in advance, justifying application for a visa at the border, was not provided;
(nuk kemi dëshmuar mjaftueshëm se për shkak të pamundësisë reale për të aplikuar për vizë ju lejohet të aplikoni për vizë në kufi);
9. ☐ other legal reasons: _____;
(arsye të tjera ligjore);

Date and stamp of Embassy/Consulate-General/Consulate/the other Authorities responsible for the checks on persons:
(Data dhe vulë e Ambasadës/Konsullatës së Përgjithshme/Konsullatës/Autoriteteve të tjera për verifikimin e të huajve);

_____/_____/_____(dd/mm/yyyy)

Signature of the Consul
(Nënshkrimi i Konsullit)

REMARKS/(VËREJTJE):

Within 5 working days as from receiving this notification, the person concerned may appeal against the decision to refuse/annul a visa as provided for in national Law 79/2021 "On Foreigners". (Brenda 5 ditë pune prej marrjes së këtij njoftimi, i huaji i interesuar ka të drejtë të apelojë kundër vendimit të refuzimit/anulimit të vizës siç parashikohet nga ligji 79/2021 "Për të huajt". Autoriteti përgjegjës është): The authority responsible is:

The person concerned must receive a copy of this document/(Personi i interesuar duhet të pajiset me një kopje të këtij dokumenti).



Aneksi nr. 2

Ministry for Europe and Foreign Affairs of Republic of Albania/Directorate for Consular Issues

Adress: Boulevard “Gjergj Fishta” No. 6; 1000 Tirana; **Tel.:** 00355 -423 64 090 ext. 157; **Email:** visa@mfa.gov.al

The person concerned must receive a copy of this document/ *(Personi i interesuar duhet të pajiset me një kopje të këtij dokumenti).*



Aneksi nr. 3

BORDER VISA FORM

(Formular Viza kufiri)

According to Law 79/2021 "On Foreigners" Art.25 Paragraph d

(Bazuar në Ligjin 79/2021 " Për të Huajt " Nen. 25 pika d)



REPUBLIC OF ALBANIA

Republika e Shqipërisë

MINISTRY FOR EUROPE AND

FOREIGN AFFAIRS

Ministria për Evropën dhe Punët e

Jashtme

I. Information on visa applicant (Të dhëna për aplikantin)

1. Surname: _____
(Mbiemër)
2. Full Name: _____
(Emër)
3. Place of Birth: _____
(Vendlindja)
4. Date of birth: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(Datëlindja dd/mm/vvvv)
5. Nationality: _____
(Shtetësia)
6. Passport number : _____
(Numri i pasaportës)
7. Passport Type: _____
(Tipi i pasaportës)
8. Passport Issuing Date: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(data e lëshimit të pasaportës)
9. Passport Date of Expiry ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(Vlefshmëria e pasaportës)
10. Date of Arrival in Albania ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(Data e hyrjes në Shqipëri)
11. Entry Border Point in Albania _____
(Pika kufitare e hyrjes në Shqipëri)
12. Duration of Stay _____
(kohëzgjatja e qëndrimit)
13. Purpose of traveling: _____
(Motivi i udhëtimit)

Address/Adresa:

Directorate for Consular Issues
Drejtoria për Çështjet KonsulloreBulevardi Gjergj Fishta 6
1000 Tirana;

Tel.: 00355-4- 23 64 090 ext. 157

Mobile: 0693766600

Email: DK@mfa.gov.al;visa@mfa.gov.al

Signature of the applicant:

(Nënshkrimi i kërkuar)

Place (Vendi)

Date (data)

Only for official remarks. Please do not write here.

(Vetëm për shënime zyrtare)

Marraja:
Shqyrtimi:

Application Form V21

Formular aplikimi



VENDIM

Nr. 554, datë 29.12.2022

PËR NDARJEN ME SHORT TË
ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 118, pika 1, 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 25, pika 3, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 2, shkronja “ë”, nenin 94, pika 4, si dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të anëtarëve z. Ilir Rusi, znj. Brikena Ukperaj dhe znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

I. Objekti dhe parimet

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë. Rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, do të rregullohen me një akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes dhe objektivitetit.

II. Ndarja e çështjes me short elektronik dhe kodi unik i organizimit të shortit

1. Zhvillimi i shortit në njësi përpunimi dhe ruajtje kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre.

2. Sistemi i shortit përdor algoritme për autentifikimin e gjykatës që kërkon procesin e shortimit. Çdo gjykatë përdor “çelësa të ndarë” (*shared key*) për të gjeneruar kod unik të çastit (*One Time Password*). Kjo procedurë synon garantimin e procedimit të mesazheve të dërguara vetëm nga gjykatat dhe çdo mesazh i tillë ka një autentifikimin të paimitueshëm në rast të gjurmimeve në rrjet (*Man In The Middle Attacks*).

3. Të dhënat e shortimeve ruhen të plota, në mënyrë historike, të lidhura në mënyrë unike të

paimitueshme me mesazhet sekuenciale, duke bërë procesin e auditueshëm dhe të dhënat e pa modifikueshme.

4. Sistemi elektronik i shortimit auditohet në mënyrë të automatizuar, nëpërmjet verifikimit të ekuivalencës së rezultatit të ruajtur lokalisht me atë në sistemin qendror dhe verifikimit të kodeve për të garantuar integritetin e bllokut të informacionit të ruajtur.

5. Sistemi elektronik i shortimit prodhon raporte periodike të auditimit ose mbi bazë të kërkesave për auditim (gjurmim) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

III. Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short

1. Çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit.

2. Kryetari i Gjykatës merr masa për organizimin e ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit elektronik, duke përcaktuar orën në të cilën realizohet procedura e shortit elektronik. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

3. Ndarja e çështjeve me short, si rregull, realizohet çdo ditë pune në rrugë elektronike me anë të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

4. Në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shortohen jo më vonë se dita e nesërme e punës.

5. Në short përfshihen të gjitha çështjet e regjistruara në sistemin e menaxhimit të çështjeve deri në momentin e orës së publikuar të shortit.

6. Procesi i shortimit për ndarjen e çështjeve realizohet në sallë gjykimi dhe shfaqet në kohë reale në monitorët e vendosur në ambientet e hyrjes së gjykatës për aq sa është e mundur.

7. Raporti i shortimit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

8. Shorti elektronik cakton gjyqtarin e çështjes, i cili është kryetari i trupit gjykues ose gjyqtarin relator, në rastet kur çështja gjykohet me trup gjykues.

9. Çështjet gjyqësore u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve, sipas organizimit të brendshëm të gjykatës.



10. Barazia në ndarjen e çështjeve nënkupton ndarjen në numër të barabartë mes gjyqtarëve të seksionit përkatës, të çështjeve të regjistruara për short, pavarësisht nga ngarkesa individuale e çdo gjyqtari në kohën e hedhjes së shortit.

11. Në çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, shorti për caktimin e gjyqtarit të çështjes, hidhet ndërmjet gjyqtarëve të seksionit përkatës. Në mungesë të këtij të fundit, shorti hidhet ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e këtyre çështjeve penale.

12. Tërësia e veprimeve të shortimit në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve dokumentohet dhe vendoset në çdo rast në dosjen gjyqësore dhe bëhet pjesë përbërëse e saj.

13. Kancelari i gjykatës mbikëqyr procesin e shortimit dhe nënshkruan kalimin e praktikës së regjistrimit të çështjes, sipas formës standarde bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

14. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short pezullohet gjatë procesit të mbartjes së dosjeve, si dhe gjatë lejes vjetore në muajin gusht. Afati i pezullimit përcaktohet me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës.

15. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon periodikisht manualin e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, përfshirë rubrikën e shortimit elektronik.

IV. Përfshirja e çështjeve gjyqësore nga shorti

1. Përfshirja nga ndarja me short:

a) kërkesat për të cilat ligji parashikon afate shqyrtimi, jo më shumë se 72 orë për gjykatën e shkallës së parë dhe jo më shumë se 10 ditë për gjykatën e apelit, të cilat shqyrtohen nga gjyqtarët e listës së gatishmërisë, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

b) kërkesat e paraqitura rishtazi, për të cilat ligji procedural parashikon shqyrtimin nga gjyqtari i hetimeve paraprake apo nga gjyqtari i seancës paraprake;

c) çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, si edhe çdo vendim tjetër, që pa e zgjidhur çështjen në themel, i jep fund procesit gjyqësor të filluar sipas ligjit;

d) çështjet gjyqësore për të cilat është pranuar gjykimi i shkurtuar;

e) çdo kërkesë apo çështje gjyqësore për të cilat ligji ka parashikuar shqyrtimin nga i njëjti trup gjykues.

2. Kryesekretaria, nën mbikëqyrjen e kancelarit, kryen verifikimin paraprak të çështjeve të paraqitura, me qëllimin për të përjashtuar nga ndarja me short, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij të kreut IV, si dhe parashikimeve të pikës 1 të kreut V.

3. Verifikimi paraprak kryhet bazuar në dokumentin e identifikimit, që i bashkëngjitet padisë apo kërkesës për gjykim nga pala apo përfaqësuesi i tij.

4. Kur nga të dhënat paraprake evidentohet se çështja është e njëjtë, me atë për të cilën gjykata më parë ka disponuar në mënyrë jopërfundimtare, atëherë çështja kalohet automatikisht tek e njëjta trup gjykues, nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Në rastet kur çështja nuk mund të shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues, ajo përfshihet në shortin elektronik të radhës.

V. Përfshirja e çështjeve nga shorti

1. Përfshirja nga shorti gjyqtari, i cili ndodhet përpara njëre prej pengesave ligjore të tilla si:

a) gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë gjykimi përfshirë nga shorti në shkallët e tjera;

b) gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit përfshirë nga shorti në rigjykim, përveçse kur është urdhëruar ndryshe nga një gjykatë më e lartë;

c) gjyqtari që ka shqyrtuar në themel kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, përfshirë nga shorti për të gjykuar kërkesat në seancë paraprake dhe kërkesat në gjykimin në themel të çështjes;

d) gjyqtari i seancës paraprake përfshirë nga shorti për kërkesat në gjykimin në themel të çështjes, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2. Kryetari i Gjykatës, pas kërkesës së motivuar të gjyqtarit, mund të përjashtojë nga shorti pjesërisht apo tërësisht gjyqtarin, gjatë lejes së papaguar, me afat deri në 30 ditë. Në këto raste Kryetari i Gjykatës disponon me vendim të arsyetuar.

3. Kryetari i gjykatës përfshirë gjyqtarin nga shorti, menjëherë me miratimin e dorëheqjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



4. Kryetari i gjykatës, me vendim të arsyetuar, përjashton nga shorti gjyqtarin që mungon në detyrë për shkaqe të justifikuara, vetëm për ato çështje që lidhen me afate të ngutshme shqyrtimi. Në çdo rast shkaku i mungesës duhet të ketë lindur dhe t'i jetë bërë i ditur kryetarit para hedhjes së shortit.

5. Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, kur mekanizmi i rindarjes së çështjeve nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar, përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short e çështjeve, deri në sigurimin për aq sa është e mundur, e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve.

6. Kryetari i gjykatave të mëdha mund të marrë një ngarkesë pune, jo më pak se 50% të ngarkesës së çdo gjyqtari, ndërsa kryetari i gjykatave të një madhësie mesatare e atyre të vogla, një ngarkesë pune jo më pak se 75% të ngarkesës së punës së një gjyqtari.

VI. Ndarja e çështjeve me short manual.

1. Në rastin kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk funksionin në mënyrë të

dokumentuar, për më shumë se dy ditë pune, ndarja e çështjeve realizohet përmes shortit manual.

2. Ndarja e çështjeve me short manual realizohet nga Kancelari, nën mbikëqyrjen e kryetarit të Gjykatës, si dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve të gjykatës, pasi janë njoftuar paraprakisht për zhvillimin e shortit manual.

3. Në çdo rast shorti manual i çështjeve kryhet duke respektuar parimin e transparencës, ndarjes së barabartë të çështjeve mes gjyqtarëve të së njëjtit seksion, si dhe caktimit rastësor të gjyqtarëve.

4. Procedura e ndarjes së çështjeve me short manual dokumentohet në procesverbal dhe publikohet në faqen e internetit të gjykatës. Në çdo rast një kopje e procesverbalit të dokumentimit të procedurës së shortit manual bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E _____
_____Nr. _____ Regj. Themeli
Datë _____ Regjistrimi**KALIM PRAKTIKE ÇËSHTJE GJYQËSORE**

Unë _____ me detyrën e Kancelarit të Gjykatës së _____, bazuar në nenin 25 pika 1 dhe 2 , në nenin 39 pika 1, germa “c” të ligjit 98/2016 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushteti Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSA:**KALIMIN E PRAKTIKES SË ÇËSHTJES GJYQËSORE**

Nr. Unik Shorti _____
Nr. Sistemi Elektronik _____
Datë shorti _____
Gjyqtar _____

KANCELAR

**VENDIM**

Nr. 558, datë 29.12.2022

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE
DISIPLINORE PËR KANCELARIN,
KËSHILLTARIN DHE NDIHMËSIN
LIGJOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 69 dhe vijuese të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 61, pika 2, shkronja “ë”, “f” dhe “j”, 90 pika 1, shkronjat “c” dhe “ç”, 97, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami**

RREGULLORE**PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE
DISIPLINORE PËR KANCELARIN,
KËSHILLTARIN DHE NDIHMËSIN
LIGJOR****KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë parime të përgjithshme dhe rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë, konkretisht Kancelarit, Këshilltarit dhe Ndhmësit Ligjor.

Neni 2**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është rregullimi i procedurave të zbatueshme gjatë verifikimit të ankesave të paraqitura nga çdo person fizik dhe juridik apo çdo nëpunës civil gjyqësor apo punonjës tjetër i gjykatës ndaj Kancelarit, Këshilltarit dhe Ndhmësit Ligjor dhe hetimit të shkeljeve disiplinore, si dhe propozimit për fillimin e procedimit disiplinor, shqyrtimit e procedimeve disiplinore dhe vendimarrjeve në lidhje me to.

Neni 3**Përkufizime**

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ditë” janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune;
2. “Kryetari” është Kryetari i Gjykatës përkatëse, ku nëpunësi civil gjyqësor ushtron funksionet e tij;
3. “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor;
4. “Komisioni” është Komisioni Disiplinor;
5. “Ligji për qeverisjen” është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar;
6. “Ligji për nëpunësin civil” është ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;



7. “Ligji për pushtetin gjyqësor” është ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

8. Nëpunësit civilë gjyqësorë, procedura disiplinore ndaj të cilëve rregullohet sipas kësaj rregulloreje janë:

a) kancelari;

b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë;

c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit.

9. “Relator” është çdo anëtar i Komisionit Disiplinor, i caktuar me short për një çështje, në zbatim të nenit 63, të ligjit “Për qeverisjen”, i cili kryen dhe kujdeset për zhvillimin e procedurës administrative dhe disiplinore në Komision dhe Këshill;

Neni 4

Parimet e procedurave disiplinore

Procedurat disiplinore ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë zhvillohen në respektim të zbatimit të përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të mëposhtme:

a) së drejtës për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

b) parimit të ligjshmërisë;

c) parimit të akuzës;

d) parimit të barazisë para ligjit;

e) parimit të transparencës;

f) prezumimit të pafajësisë;

g) parimit të dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;

h) parimit të proporcionalitetit;

i) parimit të konfidencialitetit dhe të së drejtës për jetë private dhe mbrojtjes së të dhënave personale;

j) shmangies së çdo konflikti interesi, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 5

Procedurat disiplinore

Procedurat disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë, përfshijnë si vijon:

a) verifikimin paraprak të ankesave të paraqitura nga çdo person fizik apo juridik, duke përfshirë çdo

nëpunës civil gjyqësor apo punonjës tjetër të gjykatës ndaj çdo nëpunësi civil gjyqësor, sipas përcaktimeve në ligjin për pushtetin gjyqësor;

b) hetimin e shkeljeve disiplinore dhe propozimin për fillimin e procedimit disiplinor;

c) shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe kur është rasti, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligj;

ç) ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor;

d) ankimin ndaj vendimeve të organit kompetent.

KREU II

PROCEDURAT HETIMORE

Neni 6

Ankesa dhe kriteret për pranueshmërinë

1. Kryetari i Gjykatës përkatës shqyrton çdo ankesë të paraqitur sipas nenit 72, pikat 1 dhe 2 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

2. Ankesa, së bashku me dokumentet shoqëruese, nëse ka, paraqitet personalisht, me anë të shërbimit postar apo postës elektronike. Kryetari i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj.

3. Ankesa paraqitet në formë të shkruar, si dhe përmban:

a) gjenealogjet dhe adresën e ankuesit, si dhe kërkimin e ankuesit për ruajtjen e konfidencialitetit, nëse kërkohet prej tij;

b) përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur;

c) emrin dhe mbiemrin e nëpunësit civil gjyqësor ose të dhëna mbi identifikimin e tij;

4. Ankesa pranohet për shqyrtim nga Kryetari, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

a) paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3 të këtij neni;

b) u referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;

c) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues;

ç) bëhet ndaj sjelljes së nëpunësit civil gjyqësor, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;



d) bëhet ndaj sjelljes së nëpunësit civil gjyqësor, të parashikuar si shkelje disiplinore nga legjislacioni në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

dh) bëhet ndaj sjelljes së nëpunësit civil gjyqësor që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

5. Kryetari vendos verifikimin e ankesës ose arkivimin e saj nëse nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë të parashikuar në këtë nen. Vendimi për arkivimin e ankesës, në formë të arsyetuar, i njoftohet ankuesit dhe nëpunësit civil gjyqësor, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 7

Shqyrtimi paraprak i ankesës

1. Pas verifikimit të ankesës, Kryetari, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së ankesës, vendos:

- a) të arkivojë ankesën;
- b) të fillojë hetimin disiplinor.

2. Vendimi për arkivimin e ankesës, në formë të arsyetuar, i njoftohet ankuesit dhe nëpunësit civil gjyqësor, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.

3. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e saj, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar, nëse Kryetari vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

Neni 8

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Kryetari i Gjykatës fillon hetimin disiplinor nëse ka dyshime të arsyeshme bazuar në fakte dhe provat e mbledhura, se shkelja mund të jetë kryer. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit disiplinor, i njoftohet ankuesit, nëpunësit civil gjyqësor dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor përmban:

- a) të dhënat identifikuese të nëpunësit civil gjyqësor;
- b) objektin e hetimit, duke parashtruar shkeljet e dyshuara;
- c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduar;
- ç) provat e disponueshme;

d) periudhën kohore të hetimit;

dh) parashtrimin e të drejtave të nëpunësit civil gjyqësor në lidhje me hetimin, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtesa dhe dokumente mbështetëse brenda një muaji nga marrja e njoftimit për vendimin e fillimit të hetimit.

3. Kryetari fillon hetimin me iniciativën e tij, brenda gjashtë muajve nga marrja e informacionit dhe fakteve të rëndësishme, bazuar në të dhëna thelbësore që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

4. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 6, pika 4, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje.

5. Kryetari thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga institucione publike apo subjekte private, dëshmitarë, dhe/ose nëpunësi civil gjyqësor ose mbikëqyrësit e tyre, dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

6. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Kryetari merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit.

7. Kryetari mund të vendosë shtyrjen e afatit gjashtë mujor të hetimit disiplinor edhe me gjashtë muaj të tjerë, në rastet e mëposhtme:

- a) kur nëpunësi civil gjyqësor është i sëmurë ose kur nuk mund të paraqitet për shkaqe të justifikuara të vlerësuara rast pas rasti nga Kryetari i Gjykatës;
- b) kur vendoset zgjerimi i hetimit disiplinor ose kur ndryshon shkaku ligjor i hetimit;
- c) në raste të tjera komplekse.

8. Vendimi për ndryshimin apo shtimin e objektit të hetimit, shtyrjen e afatit të hetimit, mbylljen apo rifillimin e hetimit, u njoftohet palëve brenda pesë ditëve nga marrja e tyre.

Neni 9

Pezullimi i hetimeve dhe procedimit disiplinor

1. Organi kompetent, sipas kësaj rregulloreje, pezullon hetimin ose procedimin disiplinor nëse janë duke u kryer procedura penale, administrative ose civile:



a) në të cilat, njëra nga palët është nëpunësi civil gjyqësor që i atribuohet shkelja;

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte.

2. Hetimi ose procedura disiplinore pezullohet deri në dhënien e vendimit gjyqësor përfundimtar.

3. Ankuesi, gjatë fazës së hetimit, nëpunësi civil gjyqësor përkatës, gjykatat dhe prokuroritë njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykatat dhe prokuroritë e interesuara dorëzojnë pa vonesë çdo vendim që është marrë për procedurat përkatëse.

4. Vendimi përfundimtar për pafajësinë ose rrëzimin e kërtimeve ndaj nëpunësit civil gjyqësor, në kuadër të një procesi penal, administrativ ose civil nuk përjashton hetimin ose caktimin e përgjegjësisë disiplinore të nëpunësit civil gjyqësor.

5. Organi kompetent u referohet vetëm fakteve, mbi të cilat bazohet vendimi përfundimtar, dhe jo dënimit ose pafajësisë së dhënë në vendim.

6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 10

Marrja në pyetje

1. Kur Kryetari vlerëson se marrja në pyetje e nëpunësit civil gjyqësor, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

2. Kryetari siguron që seanca e marrjes në pyetje të regjistrohet në audio, sipas procedurës së mëposhtme:

a) personi që merret në pyetje informohet se seanca përkatëse do të regjistrohet në audio;

b) regjistrimi përmban gjenealogjetet e personave që janë thirrur për t'u pyetur;

c) në rast ndërprerjeje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës;

ç) në përfundim të seancës, personi i marrë në pyetje mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe regjistrohen korrigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklaratimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje regjistrohet ora e përfundimit të saj.

3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në

pyetje përmbledhet në procesverbal, si dhe mund të transkriptohet. Nëpunësi civil gjyqësor nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur.

4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është bërë i mundur, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

Neni 11

Dokumentacioni i hetimit

1. Kryetari i Gjykatës dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali përmban:

a) emrin dhe mbiemrin e Kryetarit që kryen veprimin;

b) datën e kryerjes së veprimit;

c) subjektin dhe objektin e veprimit;

ç) pjesëmarrësit;

d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;

dh) nënshkrimin e Kryetarit në fund të çdo faqeje, si dhe të personave që marrin pjesë në këto veprime.

Neni 12

Përfundimi i hetimit disiplinor

1. Në përfundim të hetimeve të kryera sipas afateve ligjore, Kryetari përgatit raportin e hetimit disiplinor, i cili përmbledh faktet, listën e provave, rëndësinë e tyre, si dhe konkluzionet që argumentojnë se këto fakte përbëjnë shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas ligjit "Për nëpunësin civil".

2. Bazuar në parashtrimet e raportit të hetimit disiplinor, Kryetari i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore, brenda gjashtë muajve nga fillimi i hetimeve.

3. Raporti i hetimit disiplinor si dhe materialet/dokumentet e mbledhura gjatë këtij hetimi, i njoftohen nëpunësit civil gjyqësor brenda pesë ditëve nga data e marrjes së vendimit për fillimin e procedimit disiplinor.



Neni 13

Mbyllja e hetimit disiplinor

1. Kryetari i Gjykatës miraton me vendim mbylljen e hetimit disiplinor, brenda gjashtë muajve nga fillimi i tyre, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit, se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;

ç) nëpunësit civil gjyqësor i mbaron statusi sipas parashikimeve të ligjit për nëpunësin civil;

d) nëpunësit civil gjyqësor ka vdekur.

2. Kryetari i Gjykatës njofton vendimin nëpunësit civil gjyqësor ose përfaqësuesit të tij, ankuesit dhe Këshillit. Vendimi përmban arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në rastet kur nëpunësit civil gjyqësor ka dalë në pension, Kryetari harton raportin përfundimtar, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet. Raporti mbyll procesin hetimor, si dhe iu njoftohet palëve dhe Këshillit.

4. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional, i paraqiten organit kompetent për shqyrtim të mëtejshëm.

Neni 14

Rihapja e hetimit disiplinor

1. Në rast se pas përfundimit të afatit të hetimit, zbulohen prova të reja, të cilat tregojnë në mënyrë të arsyeshme se shkelja ka ndodhur, Kryetari rihap hetimin, me kusht që afati i parashkrimit të mos ketë përfunduar.

2. Kryetari i Gjykatës paraqet propozimin për caktimin e masës disiplinore ose miraton me vendim mbylljen e hetimit brenda gjashtë muajve nga vendimi për rifillimin e hetimit.

Neni 15

Ankimi i mosveprimit administrativ

Në rast se Kryetari nuk vepron brenda afateve të parashikuara në pikat 2 deri në 4 të nenit 71 të Ligjit për pushtetin gjyqësor, nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ankimojë mosveprimin administrativ në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

KREU III

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 16

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor depozitohet në Këshill nga Kryetari i Gjykatës ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Bashkë me kërkesën depozitohet raporti i hetimit dhe i gjithë dokumentacioni përkatës i mbledhur gjatë procedurës hetimore.

2. Pas regjistrimit, kërkesa e Kryetarit i përcillet Kryetarit të Komisionit Disiplinor, i cili kalon çështjen në mbledhje plenare për caktimin e relatorit.

3. Për çdo çështje të regjistruar për shqyrtim formohet një dosje e veçantë, në të cilën administrohet dhe numërohet, i gjithë dokumentacioni, i krijuar dhe i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështjeje në Komision si dhe në Këshill.

Neni 17

Procedura e shortit

1. Procedura e shortit realizohet, duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore dhe të barabartë të ngarkesës së punës midis anëtarëve të Komisionit.

2. Bazuar në arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi bazën e kërkesës së motivuar të Kryetarit ose të çdo anëtari të Komisionit, mbledhja plenare e Këshillit gjatë procedurës së hedhjes së një shorti, mund të vendosë:

a) përjashtimin e një anëtari nga shorti;

b) përfshirjen në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, dhe të anëtarëve zëvendësues. Në këtë rast Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe një anëtar i përhershëm, nga radhët e gjyqtarëve ose



jogjyqtarëve, në varësi të radhëve nga vjen anëtari zëvendësues, i caktuar si relator;

c) rregulla të tjera për mënyrën e hedhjes së shortit, në varësi të rrethanave dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës.

3. Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë.

4. Shorti hidhet midis anëtarëve të Komisionit, duke u bazuar në forma elektronike për caktimin e relatorit. Deri në përcaktimin dhe vendosjen e tyre, shorti hidhet manualisht sipas procedurës së vendosur në Këshill.

5. Në çdo rast, referuar nenit 63, pika 2, të ligjit për qeverisjen, Kryetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.

Neni 18

Detyrat e Relatorit të çështjes

1. Relatori përgatit çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit, si dhe në mbledhjen plenare të Këshillit.

2. Relatori, me mbështetjen e personelit administrativ të caktuar, kryen dhe kujdeset për detyrat, si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

a) përgatit projektaktet dhe relacionet mbi çështjen;

b) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të informacionit shtesë për procesin e vendimmarrjes së Komisionit dhe mbledhjes plenare të Këshillit;

c) merr masat për të hartuar të gjitha aktet procedurale, deri në përfundimin e çështjes;

ç) koordinon me Kryetarin e Këshillit ose Komisionit për përgatitjen, respektivisht, të mbledhjes së Këshillit ose Komisionit;

d) njofton subjektet e procedimit administrativ.

3. Kryetari i Komisionit, me kërkesë të Relatorit dhe në koordinim me anëtarin tjetër, cakton datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes në Komision.

4. Rregullat e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit në procedurat disiplinore janë të njëjta me ato të zhvillimit të mbledhjes plenare të Këshillit, për aq sa ato janë të zbatueshme dhe sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë në Këshill, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për Komisionin.

Neni 19

Detyrat e personelit administrativ

1. Komisioni mbështetet në veprimtarinë e tij nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse, duke përmblusur këto detyra, por pa u kufizuar në to:

a) regjistrimin e të dhënave në regjistrat e posaçëm, në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill dhe në veçanti:

i. identifikon natyrën e çështjes;

ii. regjistron dhe numëron atë në regjistrin përkatës;

iii. krijon dosjen e çështjes.

b) përcjelljen e çështjes Kryetarit të Këshillit për të vijuar sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për hedhjen e shortit;

c) dorëzimin e dosjes së çështjes te Relatori dhe bashkëpunon me personat përgjegjës, për mbarëvajtjen e të gjithë procedurës;

ç) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit;

d) mbajtjen e të gjitha komunikimeve të vazhdueshme, të njoftimeve dhe të akteve shkresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e urdhërimeve të Relatorit, Komisionit ose të Këshillit;

dh) redaktimin e akteve të Komisionit në këndvështrimin gjuhësor;

e) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;

ë) marrjen e masave për njoftimin e akteve sipas urdhërimeve të Relatorit;

f) marrjen në dorëzim të dosjes nga Relatori në përfundim të procedurës dhe depozitimin e saj për arkivim;

g) ndjek procedurën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit, mbi ankimin e palëve në procedurë, përveç kur me vendim të Këshillit vendoset ndryshe;

gj) vënien në dispozicion strukturave të Këshillit dhe Komisionit të çdo lloj informacioni, dokumentacioni dhe statistike, sipas kërkesës së tyre, për qëllime të procedurës.

2. Me fillimin e procedurës, sipas kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm cakton personelin administrativ përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.



3. Personeli administrativ i caktuar, sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore, në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe personelin administrativ zëvendësues nga anëtarët e personelit të Këshillit.

Neni 20

Mënyrat e njoftimit të akteve

Aktet e procedurës, sipas kësaj rregulloreje u njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:

- a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;
- b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;
- c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga palët.

Neni 21

Shqyrtimi paraprak i çështjes

1. Komisioni, pas shqyrtimit të çështjes dhe relacionit dhe projekt aktit të përgatitur nga relatori, verifikon procedurën e ndjekur dhe kur e konsideron të rregullt, vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhje plenare për të vlerësuar dhe vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore ose rrëzimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, në rastet e parashikuara nga neni 74, pika 1, të ligjit për pushtetin gjyqësor.

2. Në rastin e kalimit të çështjes në seancë dëgjimore, Këshilli vendos për caktimin e datës për zhvillimin e seancës dëgjimore brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Kryetari i Gjykatës.

3. Në rastin e vendimit për caktimin e seancës dëgjimore, Këshilli mban në vlerësim:

- a) njoftimin e palëve në procedurë për datën e seancës, të paktën 15 ditë para saj; si dhe

b) afatin brenda të cilit nëpunësi civil gjyqësor paraqet parashitë me shkrim.

4. Këshilli rrëzon kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore sipas pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban dhe shkaqet e rrëzimit të kërkesës për fillim procedimi disiplinor.

5. Vendimet sipas këtij neni i njoftohen palëve në procedurë.

Neni 22

Të drejtat e nëpunësit civil gjyqësor pas vendimit të caktimit të seancës dëgjimore

1. Relatori, bashkë me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur nëpunësit civil gjyqësor të drejtat, si vijon:

- a) për t'u njohur me dokumentet e dosjes dhe për të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij;
- b) për të paraqitur një parashitë me shkrim brenda një afati të caktuar;
- c) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
- d) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
- e) për të paraqitur prova;
- f) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative;
- g) për të kërkuar përjashtimin e relatorit, të një ose disa anëtarëve të Këshillit, nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës disiplinore, vetëm gjatë fazës paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e nenit 75 të ligjit për qeverisjen dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes;
- h) për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

Neni 23

Publiciteti i seancës

1. Seanca dëgjimore është publike.

2. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënieve me median, të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit.



3. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:

a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërket nga autoritetet kompetente;

b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të nëpunësit civil gjyqësor ose një personi tjetër;

c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

4. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve. Në çdo rast votimi është i hapur dhe publik.

Neni 24

Zhvillimi i seancës dëgjimore

1. Kryetari i Këshillit, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit merr pjesë në mbledhje në distancë, Kryetari i Këshillit merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, Kryetari i Këshillit, si drejtues i seancës, kryen këto veprime procedurale:

a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative;

b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;

c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;

d) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore;

e) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:

i. Kryetarit, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masën disiplinore;

ii. Nëpunësit civil gjyqësor të proceduar ose përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse.

f) komunikon vendimin e Këshillit:

i. për shtyrjen e seancës dëgjimore;

ii. për administrimin e provave, që plotësojnë

kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes;

iii. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;

iv. për mbylljen e fazës së shqyrtimit;

g) fton palët për pretendimet e fundit;

h) shpall vendimin përfundimtar të procedimit.

3. Për zhvillimin dhe dokumentimin e seancës dëgjimore respektohen, me aq sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara për mbledhjet plenare.

Neni 25

Shqyrtimi i kërkesës për procedim disiplinor

Këshilli gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, kryen veprimet e mëposhtme:

a) shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen;

b) merr prova shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;

c) kur e konsideron të përshtatshme, thërret ekspertë;

ç) kryen çdo veprim tjetër që vlerësohet i nevojshëm ose i përshtatshëm për trajtimin e çështjes.

Neni 26

Marrja e vendimit në përfundim të procedimit disiplinor

1. Në përfundim të seancës dëgjimore, Këshilli vendos:

a) pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës disiplinore;

b) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

2. Gjatë marrjes së vendimit zbatohen sa është e mundur dhe rregullat e parashikuara për mbledhjet plenare të Këshillit.

3. Këshilli nuk është i detyruar t'i qëndrojë masës disiplinore të propozuar dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda një muaji nga përfundimi i seancës.

4. Vendimi përfundimtar i Këshillit përmban, të paktën këto të dhëna:



- a) organin kompetent për propozimin e fillimit të procedimit disiplinor;
- b) nëpunësin civil gjyqësor, subjekt të procedimit disiplinor;
- c) objektin dhe bazën ligjore të kërkesës;
- ç) procedurën e zhvilluar në Këshill;
- d) rrethanat e faktit siç janë konstatuar gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore;
- dh) parashtrimet e përmbledhura të palëve;
- e) arsyetimin e përfundimeve të nxjerra nga Këshilli në raport me faktin, provat dhe ligjin e zbatueshëm;
- ë) pjesën vendimmarrëse dhe dispozitat ligjore ku bazohet vendimi;
- f) të drejtën e ankimit, afatin për paraqitjen së tij dhe organin kompetent;
- g) datën e shpalljes së vendimit;
- gj) nënshkrimin e anëtarëve të pranishëm në dhënien e vendimit.

Neni 27

E drejta për ankim

Nëpunësi civil gjyqësor dhe Kryetari i Gjykatës kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në Gjykatën Administrative të Apelit.

KREU IV

PEZULLIMI NGA DETYRA

Neni 28

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për pezullimin nga detyra të nëpunësit civil gjyqësor, ndaj të cilit ka filluar hetimi ose procedimi disiplinor, paraqitet nga Kryetari i Gjykatës sipas nenit 77 të ligjit për pushtetin gjyqësor. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni përkatës provues.

2. Pas regjistrimit, kërkesa e paraqitur gjatë hetimit ose bashkë me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, i nënshtrohet menjëherë procedurës së shortit në caktimin e relatorit të çështjes. Nëse procedimi disiplinor ka filluar, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim Relatorit të çështjes.

3. Këshilli mund të vendosë edhe kryesisht pezullimin e nëpunësit civil gjyqësor ose marrjen e

çdo mase tjetër të përshtatshme dhe proporcionale, pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur nga Komisioni Disiplinor.

Neni 29

Shqyrtimi i kërkesës

1. Relatori, pas shqyrtimit të kërkesës ose ardhjes në dijeni të rrethanave të parashikuara në nenin 77 të ligjit për pushtetin gjyqësor, i propozon mbledhjes plenare të Këshillit:

- a) rrëzimin e kërkesës; ose
- b) pranimin e kërkesës dhe pezullimin nga detyra; ose
- c) pranimin e kërkesës dhe marrjen e një mase tjetër të përshtatshme dhe proporcionale.

2. Këshilli merr vendim në lidhje me kërkesën brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj.

3. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në Gjykatën e Apelit Administrativ. Paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

4. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e ndryshimit të kohëzgjatjes apo të revokimit të pezullimit. Relatori i propozon mbledhjes plenare të Këshillit, sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose
- c) lënien në fuqi të pezullimit.

5. Nëpunësi civil gjyqësor paguhet me pagë të plotë gjatë periudhës së pezullimit.

6. Kryetari i Gjykatës merr masat e duhura për kthimin nga nëpunësi civil gjyqësor të 50% të pagës së përfituar gjatë periudhës së pezullimit në rastet e përcaktuara në nenin 68, pika 3, germa “a” e ligjit për pushtetin gjyqësor.

KREU V

EKZEKUTIMI I MASËS DISIPLINORE

Neni 30

Ekzekutimi i masës disiplinore

1. Vendimi për caktimin e masës disiplinore ekzekutohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Njësia përgjegjëse burimeve njerëzore pranë Këshillit merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të masës disiplinore si dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e saj.



3. Me vendim të njësisë së burimeve njerëzore bëhet deklarimi i shuarjes së masës disiplinore, kryesisht apo me kërkesë të nëpunësit civil gjyqësor, brenda pesë ditëve nga plotësimi i afatit ligjor. Një kopje e vendimit i njoftohet nëpunësit civil gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

4. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.

5. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore mbahen në dosjen personale të nëpunësit civil gjyqësor dhe regjistrohen në Regjistrin Qendror të Personelit.

Neni 31

Arkivimi i praktikës dokumentare

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Modeli i formularit të ankesës

1. Këshilli i Gjykatës, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, sipas nenit 12 të saj, miraton modelin e formularit të ankesës, i cili përmban të paktën këto elemente:

a) gjeneralitetet e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij;

b) emrin dhe mbiemrin dhe pozicionin e punës së nëpunësit civil gjyqësor ose të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e tij, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) përshkrimin e veprimit ose sjelljes, ditën/ët kur është kryer veprimi, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij;

d) listën e dokumenteve që provojnë shkeljen e pretenduar.

2. Modeli i formularit publikohet në faqen zyrtare të gjykatës me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave.

Neni 33

Dispozitë kalimtare për kancelarin në detyrë të kualifikuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme dhe për procedurat disiplinore që mund të iniciohen ndaj kancelarit në detyrë, i cili me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është kualifikuar dhe lejuar për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Neni 34

Dispozitë kalimtare për kancelarin në detyrë subjekt i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të pozicionit, figurës dhe pasurisë

1. Për procedurat disiplinore që i atribuohen kancelarit në detyrë, për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të pozicionit, figurës dhe pasurisë, do të gjejnë zbatim vetëm dispozitat e neneve 6 deri 15, 28 dhe 29 të kësaj rregulloreje.

2. Kryetari i Gjykatës përkatëse, nëse ka dyshime të arsyeshme, bazuar në fakte dhe provat e mbledhura, se shkelja mund të jetë kryer, kryesisht apo mbi bazë ankese, kryen hetime të mëtejshme, sipas kësaj rregulloreje si dhe njofton menjëherë Këshillin.

3. Në përfundim të hetimeve të kryera, Kryetari i paraqet Këshillit një raport të detajuar, i cili përmbledh faktet, listën e provave, rëndësinë e tyre, si dhe konkluzionet që argumentojnë nëse këto fakte mund të përbëjnë ose jo shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas ligjit “Për nëpunësin civil”.

4. Raporti i hetimit dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, bëhen pjesë e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të pozicionit të kancelarit në detyrë dhe vlerësohen nga Këshilli në kuadër të verifikimit të figurës.

**UDHËZIM****Nr. 559, datë 29.12.2022****PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS DHE MASËS SË TRAJTIMIT FINANCIAR TË GJYQTARIT PËR SHËRBIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT, PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM, PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM DHE CAKTIMIN PËR NJË ÇËSHTJE TË VEÇANTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 61, 95, 96 dhe 97 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; në shkronjën “a”, pika 3, nenet 11, 12, 13/1, 15, 45, 46, 59 dhe 170/1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar; në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë; në vendimin nr. 22, datë 7.2.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimin nr. 30, datë 14.2.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; në vendimin nr. 23, datë 7.2.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

UDHËZON:**I. Të përgjithshme**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave më të detajuara dhe procedurës që duhet

të ndiqet në gjykata, për trajtimin financiar të gjyqtarit lidhur me shërbimin e tij në skemën e delegimit, gjatë transferimit të përkohshëm, caktimit të përkohshëm dhe caktimit për një çështje të veçantë, si dhe masën e tij.

2. Subjekte të këtij udhëzimi janë gjyqtarët e skemës së delegimit, të transferuar përkohësisht, të caktuar përkohësisht apo të caktuar për gjykimin e një çështjeje të veçantë, sipas vendimit nr. 30/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

II. Përkufizime

Në kuptim të këtij udhëzimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Skema e delegimit” është tërësia e rregullave të caktimit të gjyqtarit, nga gjykata ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një periudhë kohore të caktuar dhe të shërbimit të tij në funksion të kësaj skeme, për të gjykuar çështje në çdo gjykatë.

2. “Gjyqtar i transferuar përkohësisht” është gjyqtari, i cili, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, transferohet për një periudhë të caktuar kohe, nga një pozicion i përhershëm në gjykatën e tij, në një pozicion të përkohshëm të lirë, në një gjykatë tjetër të të njëjtut nivel, sipas nenit 46, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. “Caktimi i përkohshëm i gjyqtarit” nënkupton caktimin e përkohshëm të një gjyqtari, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas nenit 59, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. “Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë” nënkupton caktimin e një gjyqtari me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për gjykimin e një çështjeje të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, sipas nenit 170/1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



5. “Paga bruto fillestare”, në kuptim të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfaqëson pagën referuese bazë dhe shtesën e pagës në grup, sipas grupeve të pagave (G1, G2, G3), në gjykatën ku gjyqtari është i caktuar në mënyrë të përhershme.

6. “Gjyqtar në skemë delegimi” është gjyqtari i caktuar në një pozicion në skemën e delegimit të krijuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të gjykuar çështje gjyqësore në çdo gjykatë.

7. “Gjyqtar në skemë delegimi pranë gjykatave të posaçme” është gjyqtari i skemës së delegimit, i cili përmbush kriteret dhe kushtet e sigurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i caktuar për të shërbyer pranë gjykatave të posaçme.

8. “Gjyqtar në skemë delegimi, i caktuar për të gjykuar një çështje gjyqësore të veçantë pranë gjykatave të posaçme”, është gjyqtari i skemës së delegimit, i cili me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar për të gjykuar një çështje të veçantë pranë gjykatave të posaçme.

9. “Trajtim financiar” është shtesa mbi pagë dhe kompensimi për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë.

10. “Ditë” për qëllime të këtij udhëzimi konsiderohen ditë pune.

11. “Territor” konsiderohet njësi administrative/bashkia ku ndodhet gjykata ku gjyqtari është i caktuar, në mënyrë të përhershme në pozicion ose territori i vendbanimit të tij të përhershëm.

12. “Këshill” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

III. Mbi shtesën e pagës për gjyqtarët në skemë delegimi dhe ata të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, që nuk janë pjesë e kësaj skeme

1. Gjyqtari në skemë delegimi, i caktuar me vendim të Këshillit, përfiton 10 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare. Kjo shtesë paguhet në gjykatën ku është i caktuar në mënyrë të përhershme, me përjashtim të rasteve kur Këshilli me vendim vendos ndryshe.

2. Gjyqtari në skemë delegimi, i caktuar nga Këshilli pranë gjykatave të posaçme, përfiton për vështirësi shtesë page në masën 80 për qind mbi

pagën bruto fillestare. Kjo shtesë page paguhet nga gjykata ku është i caktuar në mënyrë të përhershme, për gjithë periudhën e ushtrimit të shërbimit pranë skemës së delegimit, me përjashtim të rasteve, kur Këshilli me vendim vendos ndryshe.

3. Gjyqtari në skemë delegimi, i cili caktohet nga Këshilli për të gjykuar çështje të veçanta pranë gjykatave të posaçme, përfiton për vështirësi shtesë page në masën 40 për qind mbi pagën bruto fillestare. Kjo shtesë page paguhet nga gjykata ku është i caktuar në mënyrë të përhershme dhe llogaritet në raport me ditët kur gjyqtari zhvillon seanca gjyqësore pranë gjykatave të posaçme.

4. Gjyqtari që nuk është pjesë e skemës së delegimit, i cili caktohet me vendim të Këshillit për të gjykuar çështje të veçanta pranë gjykatave të posaçme përfiton për vështirësi shtesë page në masën 40 për qind mbi pagën bruto fillestare. Kjo shtesë page paguhet nga gjykata ku është i caktuar në mënyrë të përhershme dhe llogaritet në raport me ditët kur gjyqtari zhvillon seanca gjyqësore pranë gjykatave të posaçme.

IV. Mbi mënyrën e kompensimit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm të gjyqtarit dhe për caktimin për një çështje të veçantë

1. Gjyqtari në skemën e delegimit, i transferuar apo i caktuar përkohësisht, në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të shkallës së parë dhe apelit, për jo më shumë se njëzet e dy ditë pune, përfiton kompensim financiar për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë gjykatës ku delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht.

2. Gjyqtari, në skemën e delegimit, i transferuar apo caktuar përkohësisht, në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të shkallës së parë dhe të apelit, për një periudhë kohore më të gjatë se njëzet e dy ditë, përfiton një kompensim mujor në masën 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e gjyqtarit në gjykatën ku gjyqtari është deleguar, transferuar apo caktuar përkohësisht.

3. Gjyqtari i caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në



mënyrë të përhershme, përfiton kompensim financiar për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë gjykatës ku caktohet por jo kompensim mujor financiar në masën 80 për qind të pagës referuese bazë.

4. Shpenzimet e transportit llogariten në bazë të distancës më të shkurtër që rezulton ndërmjet gjykatës ku ai delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht apo caktohet për një çështje të veçantë, me gjykatën ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose me vendbanimin e tij të përhershëm.

5. Gjyqtari nuk përfiton kompensim financiar sipas këtij udhëzimi, në rastet kur gjykata ku ai delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht apo caktohet për një çështje të veçantë, ndodhet në të njëjtin territor me gjykatën ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose në territorin e vendbanimit të tij të përhershëm.

V. Procedura për miratimin dhe kompensimin për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm të gjyqtarit dhe për caktimin për një çështje të veçantë

1. Gjyqtari përfitues, sipas pikave 1 dhe 3 të nëndarjes IV të këtij udhëzimi, paraqet dokumentacionin vërtetues justifikues, lidhur me shpenzimet e kryera për qëndrimin, transportin dhe dietën ditore, për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë gjykatës ku delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht apo caktohet për një çështje të veçantë, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

2. Gjyqtari përfitues sipas pikës 2 të nëndarjes IV të këtij udhëzimi, kur delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se njëzet e dy ditë, kompensohet financiarisht për çdo muaj në vlerën 80 për qind të pagës referuese bazë.

3. Kompensimi financiar realizohet pas nxjerrjes të urdhrit nga drejtuesi i gjykatës, në të cilin përcaktohet gjyqtari përfitues, periudha, si dhe masa e kompensimit financiar. Urdhri mbështetet

në dokumentacionin justifikues vërtetues, si më poshtë:

a) kërkesën e bërë me shkrim nga gjyqtari në skemë delegimi, i transferuar përkohësisht, i caktuar përkohësisht apo i caktuar për një çështje të veçantë lidhur me kompensimin;

b) vendimin e Këshillit mbi caktimin në skemën e delegimit, transferimin e përkohshëm, caktimin e përkohshëm apo caktimin për një çështje të veçantë;

c) vërtetimin e vendbanimit të tij të përhershëm;

d) dokumentacionin justifikues vërtetues sipas pikave 1 dhe 3 të nëndarjes IV të këtij udhëzimi, për rastet jo më shumë se 22 ditë pune.

4. mosparaqitja e dokumentacionit të përcaktuar në pikën e mësipërme të këtij udhëzimi përbën shkak për moskryerjen e pagesës.

5. Trajtimi financiar për gjyqtarët sipas përcaktimeve të mësipërme përballohet nga fondet buxhetore nga gjykata në të cilën gjyqtari është caktuar në mënyrë të përhershme.

6. Programimi i fondeve buxhetore të nevojshme për shpenzimet e trajtimit financiar, si pasojë e zbatimit të këtij udhëzimi bëhet nga secila gjykatë gjatë procesit të hartimit të dokumentit të projektbuxhetit për çdo vit buxhetor.

7. Gjyqtari në skemën e delegimit, gjyqtari i transferuar përkohësisht, gjyqtari i caktuar përkohësisht apo gjyqtari i caktuar për një çështje të veçantë, që ka shërbyer si më sipër përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, trajtohet financiarisht, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 50/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Ngarkohen gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të shkallës së parë dhe të apelit për zbatimin e këtij udhëzimi.

9. Ngarkohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit për auditimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

**URDHËR****Nr. 336, datë 22.12.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe nenit 14, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Ronelda Rrapollari.

2. Delegimin e kompetencave për njoftimin dhe ndjekjen e realizimit të detyrimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, Sekretarit të Përgjithshëm të AMA-s.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 22.12.2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Armela Krasniqi

VENDIM**Nr. 313, datë 6.12.2022****MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES
SË BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME
PROCEDURËN E HEQJES SË
LICENCËS SË SHOQËRISË “DOSKU-
ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të

Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2026/1 prot., datë 2.12.2022, të drejtorive teknike “Mbi procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 21.7.2022, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “C&S Construction Energy” sh.p.k., për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011, i ndryshuar

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. për shkelje të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

3. Shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

- Për shkak të kompleksitetit të kësaj çështjeje, me qëllim përfundimin e monitorimit të nisur nga ERE ndaj shoqërisë, marrjen dhe shterimin e të gjitha informacioneve përkatëse në lidhje me kapacitetin faktik me të cilin operon HEC-i Gizavesh i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., duke përfshirë këtu dhe informacionin përkatës nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), përpara marrjes së një vendimi përfundimtar në vijim të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së kësaj shoqërie, me vendimin nr. 253, datë 6.10.2022, Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Të shtyjë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i vendimit të Bordit të ERE-s, shoqëria duhet të depozitojë në ERE të gjithë dokumentacionin tekniko-financiar në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi për të gjitha asetet që shoqëria ka shtuar mbi listën e pajisjeve të impiantit për të cilën ajo është licencuar.

- Në vijim, me vendimin nr. 282, datë 7.11.2022, Bordi vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen e tij lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k. Brenda datës 10.11.2022, shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. duhet të saktësonte objektin e kërkesës e saj të datës 7.11.2022, në lidhje me



administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj. Po ashtu, brenda datës 18.11.2022 shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. duhet të parashtronte në ERE komente apo vlerësime mbi provat e administruara, si dhe çdo argument që i shërben ushtrimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur për aq sa është administruar nga shoqëria me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.

- Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit mbi të cilin është marrë vendimi i Bordit nr. 188/2022, ERE-s i është vënë në dispozicion nga shoqëria “C&S Construction Energy” sh.p.k. shkresa e AKBN-së nr. 1167/4 prot., datë 24.9.2020, me anë të së cilës ajo informon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ndër të tjera, se nga ana e shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. është rritur në mënyrë të jashtëligjshme kapaciteti i turbinës dhe gjeneratorit. Në këto rrethana ERE ka zhvilluar korrespondencë me AKBN-në, ku i ka kërkuar informacion mbi gjetjet në lidhje me kapacitetin e instaluar me të cilin operon HEC-i Gizavesh i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., referuar verifikimeve apo monitorimeve të mundshme të kryera nga ana e saj.

- Nga AKBN-ja, nuk ka pasur një përgjigje përfundimtare, deri në depozitimin e shkresës së saj, të protokolluar në ERE me nr. 1495/6 prot., datë 30.11.2022, me anë të së cilës është vënë në dijeni MIE, si dhe ERE, për shkresën drejtuar shoqërisë “Dosku-Energji” sh.p.k. dhe shoqërisë koncesionare “C&S Construction Energy” sh.p.k.

- Në këtë shkresë citohet se në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 7151 prot., datë 19.10.2022, “Dërgohet për trajtim dhe verifikim kërkesa e shoqërisë “C&S Construction Energy” sh.p.k.”, nr. 7151/1 prot., datë 1.11.2022, “Në vijim të tonës 7151 prot., datë 19.10.2022”, Entit Rregullator të Energjisë, shkresa e fundit me nr. 1495/4 prot., datë 19.10.2022, me lëndë “Kërkesë për informacion”, njoftohen këto shoqëri për marrjen e masave të menjëhershme për mundësimin e verifikimit në terren të objekteve të tyre. Po ashtu, evidentohet se në datën 16.11.2022, gjatë verifikimit në terren për trajtimin e problematikës së ngritur dhe verifikimin e parametrave të HEC-it Gizavesh, që shfrytëzohet nga shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k., AKBN-së nuk i është mundësuar verifikimi i situatës. Në përfundim AKBN-ja

kërkon marrjen e të gjitha masave nga ana e këtyre shoqërive për të mundësuar verifikim në terren në datat 1.12.2022 dhe 2.12.2022.

- Sikurse përcaktuar në shkresën e sipërcituar, objekti i verifikimit nga AKBN-ja janë parametrat teknikë të HEC-it Gizavesh, për të cilët i është kërkuar informacion dhe më parë AKBN-së, në kuadër të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., e cila ka nisur pikërisht për shkelje të kapacitetit të instaluar.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Për sa më sipër vlerësohet pezullimi i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., deri në marrjen e një informacioni nga ana e AKBN-së mbi përfundimet e verifikimit të planifikuar nga ana e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s në lidhje me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., deri në marrjen e një informacioni nga ana e AKBN-së mbi përfundimet e monitorimit të njoftuar sipas shkresës nr. 1495/6 prot., datë 30.11.2022 për verifikimin e parametrave teknikë të HEC Gizavesh.

2. Ky vendim është objekt rishikimi.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “Dosku-Energy” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 314, datë 6.12.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 395,
SERIA F18 TË SHOQËRISË “ENERGJI
ASHTA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2026 prot., datë 2.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energji Ashta” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/1 prot., datë 24.11.2022, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16 “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1 (neni 16, germa “a”); çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë (neni 16, germa

“b”); informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur) (neni 16, germa “c”) shtojca 1.I; të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE (neni 16, pika 7).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar. Po ashtu shoqëria nuk rezulton debitoare e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.a. rezulton se është pa plotësuar sa vijon:

Neni 16, pika 1, gjerat “b” dhe “c” (shtojca 1.I)

- Germa “b”, pa plotësuar.

Shoqëria duhet të na informojë nëse ka pësuar ndryshime apo modifikime të mundshme të dokumentacionit të të dhënave teknike të depozituar në aplikimin për licencë.

- Germa “c”, plotësuar pjesërisht.

Duke qenë se shoqëria nuk ka përcjellë informacion, dhe sa rezulton nga të dhënat që ERE disponon, nuk e ka ushtruar veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në vijim do t’i kërkohej të përcjelli këtë deklaratë në ERE.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet shoqëria që ta përcjellë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 395, seria F18, të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund



ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 724/7, datë 29.12.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës së mbrojtur nga lumi Osum dhe rijetëzimi i fasadave të qendrës së qytetit Ura Vajgurore”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Dimal.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në

dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Dimal, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 604,285.5 (gjashtëqind e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I ZONËS SË MBROJTUR NGA LUMI OSUM DHE RIJETËZIMI I FASADAVE TË QENDRËS SË QYTETIT URA VAJGURORE”

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (kuftizime hipotekare, barë mbi pasurinë etj.)
														ARË			TRUALL			VLERA TOTALE (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	Y	Z
1	Shtet				3682	1/192	Truall	513		513		5	126			0	34.2	2375	-	-	Mbi truallin 1/192, vol. 5, f. 126 është regjistruar ndërtesa 1/459, vol. 5, f. 127. Mbi këtë pasuri është regjistruar ndërtesa me nr. pasurie 1/788-nd, vol 13, f. 80, me pronar Skender Alaj. Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/41	Rrugë	22765		22765		1	142				58.9	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/643	Truall	175		175		8	132			0	61.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja; kjo pasuri është e okupuar nga Nasi Qyli
4	Anila	Fatmir	Majuri	Urë Vajgurore	3682	1/502	Truall	3500		3500		6	203			0	231.7	2375	550,287.5	550,287.5	Konfirmuar nga ASHK-ja; mbi këtë pasuri ka dy ndërtime të paligjshme
	Armando	Fatmir	Majuri																		
	Azis	Metin	Ruli																		
	Fatmir	Irfan	Majuri																		
	Fatmira	Ali	Selenica																		
	Gracila	Metin	Ruli																		
	Kujtim	Ali	Kuçi																		
	Luan	Ali	Kuçi																		
	Mirjana	Metin	Ruli																		
	Qurnile	Ali	Kuçi																		
	Zhaneta	Ali	Çakmashajian																		
5	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/196	Shesh	1030		1030		1	114			0	154.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/635	Rrugë	28		28		1	61			0	16.4	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/636	Shesh	236		236		1	60			0	150.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/164	Kanal	764.6		764.4		1	119			0	530.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/165	Kanal	502		502		1	118			0	371.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/166	Kanal	1130		1130		1	117			0	456.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Shtet			Urë Vajgurore	3682	1/141	Truall	492		492		1	126			0	272.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja



12	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/127	T'ruall	551		551		8	45			0	83.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja, kjo pasuri është e okupuar nga Flamur Dervishi, ka një ndërtim të paligjshëm	
13	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/129	T'ruall	346		346		8	46			0	43.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja, kjo pasuri është e okupuar nga Luan Avdo, ka një ndërtim të paligjshëm	
14	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/131	T'ruall	244		244		8	47			0	28.4	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja, kjo pasuri është e okupuar nga Izet Dodoveci, ka një ndërtim të paligjshëm	
15	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/133	T'ruall	263		263		8	50			0	45.5	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja, kjo pasuri është e okupuar nga Fejzo Dervishajka një ndërtim të paligjshëm	
16	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/136	T'ruall	458		458		8	51			0	100.6	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja, kjo pasuri është e okupuar nga Petrit Bufi, ka një ndërtim të paligjshëm	
17	Afrim Xheladin Lybeshja Eglantina Adem Lybeshja			Urë Vajguoree	3682	1/390	Arë+ T'ruall	960	960	200	106	1	6	188	203	38164	-	0	-	38,164.0	Konfirmuar nga ASHK. Me datë 10.7.2020 është kryer rivlerësimi i pasurisë në shumën 3,922,000. Ky rivlerësim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar, përveç trashëgimisë ligjore, në përputhje me udhëzimin nr.29 datë 30.7.2018. Lloji i pasurisë arë + truall R.009, 21.6.2005 lëshohet certifikatë datë 21.6.2005 me urdhrin nr. 11, u bë korrigjimi i referencës. me referencë 1897/671	
18	Saimir	Zeni	Guraj	Urë Vajguoree	3682	1/388	Arë	765	765			1	4	78	203	15834	-	0	-	15,834.0	Konfirmuar nga ASHK-ja	
19	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/139	Rrugë	488		488		1	127			0	488.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja	
20	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/86	Rrugë	2215		2215		1	130			0	404.0	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja	
21	Shtet			Urë Vajguoree	3682	1/155	T'ruall	1616		1616		1	120			0	5.9	2375	-	-	Konfirmuar nga ASHK-ja	
	SHUMA															53,998			550,287.5		604,285.5	

**KËRKESË**

çregjistrimi pranë gjendjes civile të rrethit Sarandë.

Shtetasja Emine Mejdi kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, deklarimin e vdekjes së shtetasit Kaso Mehmet Karafili, më datë 19.12.1984, e vlefshme kjo për efekt

KËRKUESE
Emine Mejdi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 536 lekë